

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5898
E martë, 8 tetor 2019
çmimi 0.40 €

Borrelli: Marrëveshja Kosovë - Serbi, ndër prioritetet kryesore

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:


www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKELZEN MALIQI ■ FAQE 4-5



FITOREN E KURTIT E SOLLI PJESËMARRJA E MADHE E VOTUESVE TË RINJ

Njohësi i rrethanave politike në vend, Shkelzen Maliqi, ka bërë me dije se faktori kryesor që ka ndikuar në fitoren e Albin Kurtit kanë qenë votuesit e rinj. Në këtë intervistë

dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se pjesëmarrja jashtëzakonisht e madhe e këtij votuesi në këto zgjedhje ka qenë determinuese për zhvendosjen e LDK-së pas LV-së.

Maliqi pret që institucionet e reja të formohen nga LDK-ja dhe LV-ja. Sipas tij, këto dy subjekte duhet t'i dëgjojnë preferencat e ndërkombëtarëve


KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) KA PUBLIKUAR REZULTATET PRELIMINARE TË ZGJEDHJEVE TË 6 TETORIT ■ FAQE 7

Rezultatet preliminare: LV-ja 31 deputetë, LDK-ja 30, PDK-ja 25 dhe AAK-ja 14'

Sipas 98 për qind të rezultateve preliminare të zgjedhjeve të parakohshme të 6 tetorit, LV-ja ka fituar 25.56 për qind apo 200 754 vota, LDK-ja 24.87 për qind apo 195 296 vota, PDK-ja 21.14 apo 166 009

vota, AAK-PSD ka fituar 11.54 për qind apo 90 617 vota dhe Lista Serbe 6.69 për qind apo 52 529 vota. Kurse koalicioni Nisma-AKR-PD nuk ka mundur ta kalojë pragun zgjedhor duke marrë 4.89 për qind apo 38

433 vota. Bazuar në këto rezultate, LV-ja do t'i ketë 31 deputetë, LDK-ja 30, PDK-ja 25 dhe AAK-ja 14. Por këto rezultate nuk përfshijnë votat me kusht, me postë dhe votat e personave me nevoja të veçanta



OPINION

PDK DHE AAK-PSD DUHET TA VOTOJNË QEVERINË KURTI PA ASNJË KUSHT! F. 12

Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE

AMERIKA ZOTON PESË MILIONË DOLLARË PËR SHKATËRRIM TË ARMËVE KONVENCIONALE NË KOSOVË F. 6

USHTARËT E FSK-së TË GATSHËM PËR GARËN NDËRKOMBËTARE 'CAMBRIAN PATROL 19' F. 6



EKONOMI

BPV-ja SHËNOI RITJE REALE PËR 4.13 PËR QIND F. 9

OAK-U E SHQETËSUAR PËR BARRIERAT E BIZNESEVE TRANSPORTUESE F. 9

SPORT



CHALLANDESI: DUHET TË FITOJMË NDAJ MALIT TË ZI F. 18

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com


Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Serwer: Populli i Kosovës donte ndryshim dhe votoi për ndryshim



Analisti Daniel Serwer thotë se rezultatet e zgjedhjeve në Kosovë nuk ishin krejtësisht të befasishme dhe se populli donte ndryshim dhe votoi për ndryshim dhe kjo është një shenjë se Kosova ka një demokraci të vërtetë, se atje mund të ketë këmbim pushteti në mënyrë paqësore dhe kjo është gjë e mirë

WASHINGTON, 7 TETOR - Analisti Daniel Serwer vlerësoi mënyrën se si u mbajtën zgjedhjet në Kosovë dhe sjelljen e partive pas tyre. Ai thotë se shpreson që të ketë një koalicion të gjerë dhe parashikon që platforma qeverisëse të jetë e përqendruar te lufta kundër korrupsionit dhe te ruajtja e integritetit territorial. Në intervistën për "Zërin e Amerikës", Serwer tha se pikërisht kjo këmbëngulje te sovraniteti, e forcon pozitën e Kosovës në bisedime të pritshme me Serbinë, por nga ana tjetër mund të tregojë që zgjidhja nuk do të jetë e shpejtë.

Ai thotë se rezultatet e zgjedhjeve në Kosovë, nuk ishin krejtësisht të befasishme dhe se populli i Kosovës donte ndryshim dhe votoi për

ndryshim. "Mendoj se është një shenjë se Kosova ka një demokraci të vërtetë, se atje mund të ketë këmbim pushteti në mënyrë paqësore dhe kjo është gjë e mirë".

Megjithëse Serweri thotë se nuk e di pse njerëzit votuan ashtu siç votuan, ai shton se pa dyshim është një mposhtje për Taçi dhe PDK-në, por se ndryshimi i pushtetit është diçka normale. "Ishte një veprim dinjitoz dhe një shenjë pozitive, që PDK-ja menjëherë tha se do të shkojë në opozitë. Mendoj se Kadri Veseli meriton vlerësim për këtë qëndrim", tha ai.

Analisti i Ballkanit thotë se ende nuk mund ta parashikojë ende se cili do të jetë efekti politikisht në vend, për sa kohë që nuk dihet se cili do të jetë kryemi-

nistër dhe cilës partie do t'i takojë. "Do të mbahen negociata për të vendosur për koalicionin qeverisës. Shpresoj të jetë një koalicion i gjerë me një shumicë të konsiderueshme votash, sepse një i tillë duhet për bisedimet me Beogradin", tha Serwer.

Duke pasur parasysh ftesën e Vetëvendosjes ndaj LDK-së për koalicion, Serweri thotë se u takon dy partive vendimi. "Me siguri që do të kenë një program që e vë theksin te lufta kundër korrupsionit, rëndësia e ekonomisë dhe integriteti territorial dhe sovraniteti i Kosovës. Mendoj se të dyja partitë nuk e pëlqenin idenë e këmbimit të territorit dhe donin ta shmangnin", tha analisti Serwer. Ai shtoi se duke qenë se qëndrimi i shprehur nga PDK-ja për të

mos qenë pjesë e qeverisë, përbën një shtysë për të dyja partitë që të formojnë një qeveri së bashku. Serwer thotë se rezultati është një sinjal kundër korrupsionit dhe mënyrës të së qeverisurit.

Lidhur me qëndrimet e Kurtit, që mund të interpretohen si izolacioniste, Serwer thotë se ai e mbështet fort anëtarësimin e Kosovës në BE dhe shton se nuk duket se për momentin ai është i prirë të këmbëngulë në qëndrimin e tij për bashkim me Shqipërinë.

Çështja kryesore, thotë Serwer është që Kosova të fillojë të punojë seriozisht për kualifikim në BE, megjithëse e pranon që do të jetë një proces i gjatë.

Për sa i takon negociatave dhe qëndrimit amerikan, Serwer

thotë se Uashingtoni do të dojë që negociatat të rifillojnë, por se ai nuk mendon se kjo do të ndodhë së shpejti dhe nuk është dakord me administratën amerikane se ka një dritare nga tani deri para zgjedhjeve serbe në prill, për një rezultat. "Nuk besoj se është në interes të Kosovës, që t'i bëhet presion për zgjidhje përpara zgjedhjeve serbe ku Vuçiçi do të përdorë argumentin se duhet të marrë diçka në këmbim që të fitojë shumicën në parlament", tha ai.

Serwer thotë se ata që menduan se Shtetet e Bashkuara do të bënin çdo përpjekje për të ruajtur atë që ai e quan "stabilokraci", bënë një gabim të madh. "Mendoj se kurdo ka një alternativë serioze qeverisëse në Ballkan, amerikanët nuk kanë qenë kundër ardhjes së saj në pushtet dhe në fakt nuk duhet të jenë kundër. Kjo është demokracia", tha Serweri.

Por me ose pa pritshmëri për një zgjidhje të shpejtë, Qeveria e Kosovës do të nxitet t'i vazhdojë negociatat dhe Serweri thotë se është vështirë të bësh parashikime. "Unë pres që Kosova të shkojë në fazën e ardhshme të bisedimeve me një qëndrim të konsoliduar, në favor të integritetit territorial dhe sovranitetit të shtetit. Dhe mendoj që do të këmbëngulë në këtë pikë, dhe kjo ndoshta do të thotë që nuk do të ketë një zgjidhje të shpejtë të problemit të statusit", tha ai.

Serweri e pranon që tarifat janë një pengesë e madhe por nuk mund të parashikojë nëse një qeveri e re do t'i heqë ato. "Besoj se varet nga ajo që do të marrin në këmbim. Nëse marrin si këmbim një mandat të qartë për një dialog për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë brenda kufijve ekzistues, mendoj se do të ishte gabim të mos i hiqnin", tha Daniel Serweri.

Erdogani: Turqia do të vazhdojë të luajë rol në stabilitetin e Ballkanit

BEograd, 7 TETOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, e ka falënderuar homologun e tij turk, Recep Tayyip Erdogan për deklaratat e tij, se do të mbështesë çfarëdo marrëveshje që mund të arrijnë serbët dhe shqiptarët.

Erdogan po qëndron në Beograd ku bisedoi për rreth një orë e gjysmë me presidentin serb, Vuçiç, për bashkëpunimin dypalësh dhe situatën në rajon.

Në konferencën për media, presidenti Vuçiç tha se "falë angazhimit të Erdoganit, është vendosur besim i madh midis Serbisë dhe Turqisë".

Raportet e mira mes dy vendeve, sipas Vuçiçit, janë të rëndësishme për paqen dhe stabilitetin në të gjithë Ballkanin.

Ndërkaq, presidenti turk Erdogan tha se Turqia do të vazhdojë të luajë rol në stabilitetin e Ballkanit.

Para vizitës në Serbi, ai kishte thënë se arritja e një marrëveshje për çështjen e Kosovës, e cila kënaq të gjitha palët e interesuara, është jetike për të arritur stabilitetin dhe paqen afatgjatë në Ballkan.

Gjatë vizitës dyditore në Serbi, Erdogan do të marrë pjesë edhe në ceremoninë e nisjes së punimeve në autostradën Beograd - Sarajevë.



Borrelli: Marrëveshja Kosovë - Serbi, ndër prioritetet kryesore



JAVIER SORIANO (AFP)

Shefi i ardhshëm i diplomacisë evropiane, Joseph Borrell, ka paralajmëruar se vizitën e parë si përfaqësues i lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri do ta bëjë në Kosovë dhe në Serbi. Në seancën e konfirmimit në Parlamentin Evropian ai ka thënë marrëveshja midis Kosovës dhe Serbisë do të jetë ndër prioritetet kryesore të tij

**EPOKA
ERE****Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 7 TETOR - Marrëveshja midis Kosovës dhe Serbisë do të jetë në mesin e prioriteteve për shefin e ri të diplomacisë evropiane, Joseph Borrell. Të hënën në seancën e konfirmimit në Parlamentin Evropian ai ka paralajmëruar se udhëtimi i parë i tij si përfaqësues i lartë i Bashkimit Evropian do të jetë në kryeqytetin e Kosovës në Prishtinë. Duke thënë se dialogu është zhvilluar "shumë gjatë", Borrelli ka premtuar se do t'i kushtojë vëmendje të posaçme këtij procesi. Ai ka thënë se të dyja palët duhet të

tregojnë përkushtim. Ka bërë me dije se nga Kosova pret ta heqë taksën e vënë ndaj prodhimeve të importuara nga Serbia, ndërsa nga Serbia pret që të ketë angazhim të sinqertë në procesin e dialogut.

I pyetur se sa do të jetë i besueshëm roli i tij, marrë parasysh se përfaqëson Spanjën, një shtet që nuk e ka njohur Kosovën, Borrelli ka thënë se njohja është përgjegjësi e secilit shtet anëtar të BE-së dhe se Spanja nuk është problem në këtë drejtim. "Për aq kohë sa nuk e njohin Rusia dhe Kina, Kosova nuk mund të jetë shtet", ka deklaruar shefi i ardhshëm i diplo-

macisë evropiane.

Megjithatë, ai ka premtuar se do të angazhohet në këtë pjesë të rajonit sepse, siç ka theksuar ai, "ka dallime midis njohjes dhe angazhimit të përbashkët". Bashkimi Evropian këtë javë, po ashtu, pritet të emërojë një të dërguar të posaçëm për dialogun për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë.

Ndërkaq më 3 tetor presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, ka zgjedhur ambasadorin amerikan në Gjermani, Richard Grenell, të dërguar të administratës së tij në dialogun Kosovë - Serbi.

Në anën tjetër, autoritetet në Serbi janë pozicionuar për mosvazhdimin e dialogut derisa të hiqet taksa. Seanca dëgjimore për Borrellin u zhvillua një ditë pasi në Kosovë u mbajtën zgjedhjet e parakohshme parlamentare, rezultatet e të cilave nxorën fituese opozitën e deritashme. Në Parlamentin Evropian do të mbahen 26 seanca dëgjimore deri në javën e ardhshme për secilin komisionar të emëruar. Më 23 tetor Parlamenti voton për Komisionin e ri Evropian që merr detyrën më 1 nëntor të këtij viti.

Kocijançiq: Qeverinë e re të Kosovës e presin detyra të rëndësishme

Ndërkohë zëdhënësja e Bashkimit Evropian (BE), Maja Kocijançiq, ka deklaruar se 6 tetori ishte një ditë e mirë për

demokracinë në Kosovë.

Në reagimin e saj fillestar pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare që u mbajtën në Kosovë, Kocijançiq ka theksuar se ishte shumë pozitiv fakti se në këto zgjedhje votuan më shumë qytetarë sesa në ato të mëparshmet në vitin 2017. "Kjo është në dobi të qytetarëve të Kosovës dhe tërë rajonit. BE-ja do ta vazhdojë punën dhe bashkëpunimin e saj me Kosovën dhe do ta promovojë pajtimin, bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë në Ballkanin Perëndimor", ka thënë Kocijançiq.

Bashkimi Evropian ka dërguar një mision monitorimi në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura në Kosovë më 6 tetor. Misioni do të paraqesë një vlerësim paraprak më 8 tetor dhe do të publikojë një raport përfundimtar në muajt e ardhshëm.

Thaçi: Me të njëjtën pjekuri politike të formohet qeveria e re

PRISHTINË, 7 TETOR - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka përgëzuar qytetarët dhe partitë politike për zgjedhjet e djeshme parlamentare. Ai ka thënë se Kosova dëshmoi edhe një herë pjekuri të lartë politike dhe demokratike. Thaçi ka sugjeruar


që të njëjtën pjekuri politike duhet ta tregojnë edhe në formimin e qeverisë së re. "I uroj qytetarët e Republikës së Kosovës dhe partitë politike për zgjedhjet shembullore, për votimin e dinjitetshëm, të lirë dhe demokratik. Kosova dëshmoi edhe një herë pjekuri të lartë

politike dhe demokratike. Tash të njëjtën pjekuri politike duhet ta tregojmë edhe në formimin e qeverisë së re, sa më parë dhe në përballje me sfidat e menjëherëshme që e presin Kosovën", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".



Flet për "Epokën e re", Shkelzen Maliqi

Fitoren e Kurtit e solli pjesëma



Njohësi i rrethanave politike në vend, Shkelzen Maliqi, ka bërë me dije se faktori kryesor që ka ndikuar në fitoren e Albin Kurtit kanë qenë votuesit e rinj. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se pjesëmarrja jashtëzakonisht e madhe e këtij votuesi në këto zgjedhje ka qenë determinuese për zhvendosjen e LDK-së pas LV-së. Maliqi pret që institucionet e reja të formohen nga LDK-ja dhe LV-ja. Sipas tij, këto dy subjekte duhet t'i dëgjojnë preferencat e ndërkombëtarëve

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 7 TETOR - Analisti politik Shkelzen Maliqi rezultatin e zgjedhjeve të 6 tetorit e ka vlerësuar befasues. Ai ka treguar për faktorët që kanë ndikuar në këto rezultate të zgjedhjeve. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Maliqi ka thënë se fitoren e liderit të LV-së, Albin Kurti, e ka sjellë pjesëmarrja e madhe e votuesve të rinj në këto zgjedhje. "Faktori kryesor mendoj se ka qenë pjesëmarrja jashtëzakonisht e madhe në këto zgjedhje, sidomos e votuesve të ri. Kjo do të thotë

se kësaj here kanë votuar mjaft të tillë që zakonisht abstenojnë. Ka qenë edhe vota e protestës për dështimet e mëdha të qeverisë së kryeministrit Haradinaj (i cili është humbës më i madh i zgjedhjeve së bashku me Fatmir Limajn e Nismës)", ka thënë Maliqi.

Ai ka deklaruar se në këtë rezultat ka ndikuar edhe komoditeti i LDK-së se do të dalë partia e parë. "Në fitoren e Albin Kurtit mbase ka ndikuar edhe fushata me mjaft komoditet e LDK-së, e cila ishte e bindur se do t'i fitojë këto zgjedhje duke nënçmuar mobilizimin e jashtëzakonisht të Kurtit", ka thënë ai.

Maliqi pret që institucionet e reja të formohen nga LDK-ja dhe LV-ja. Sipas tij, këto dy subjekte duhet t'i dëgjojnë preferencat e ndërkombëtarëve. "Dy subjekte me kapacitetet që kanë, duhet të dëgjojnë me vëmendje sugjerimet faktorëve ndërkombëtarë që edhe na kanë mundësuar të pavarësohemi, e tani kërkojnë të krijojmë sistem stabil demokratik. Është vështirë e arritshme, por jo e pamundshme", ka thënë Maliqi.

"Epoka e re": Z. Maliqi, si i keni parë rezultatet preliminare të zgjedhjeve të 6 tetorit?

Maliqi: Më kanë befasuar

mjaft sepse në sondazhet paraprake, që i kisha realizuar tri javë më parë, LDK-ja printe bindshëm, me 9 për qind diferencë. Në analizat e këtij sondazhi, e edhe një tjetër që ka qenë i përafërt me tonën, parashikim se kjo diferencë mund të ngushtohet, pra që Vetëvendosje t'i afrohet LDK-së. Këtë parashikim e bënim për shkak se vota e papërcaktuar ka qenë bukur e madhe dhe Kurti tregonte qartë se po punon edhe për mobilizimin e votës nga diaspora. Megjithatë, na dukej shumë e vështirë që të përmysej kjo përparësi e madhe e LDK-së. Mendonim se gara do të jetë e ngushtë, por renditja do të mbetet kështu: LDK-ja e para, LV-ja e dyta, PDK-ja e treta, koalicioni AAK - PSD dilte i katërti, kurse koalicioni Nisma-AKR-PD nuk e kalonte pragun prej 5 %. Këto parashikime dolën të sakta, madje edhe me përqindje siç i nxori 'exit polli' dhe rezultati zyrtar i KQZ-së. Ka qenë interesant se edhe gjatë 'exit pollit' që e realizova për "Klan Kosovën", deri në orën 12.30,

deklarimet e të anketuarave pasqyronin se LDK-ja printe me 8 për qind. Vetëm pas orës 15 filloi një cunami i votave për Vetëvendosjen që e përgjysmoi distancën dhe dy orë më vonë edhe e shkriu atë duke i dhënë një përparësi të lehtë LV-së.

"Epoka e re": Çka mendoni se ka ndikuar në fitoren e z. Kurti?

Maliqi: Faktori kryesor mendoj se ka qenë pjesëmarrja jashtëzakonisht e madhe në këto zgjedhje, sidomos e votuesve të ri. Kjo do të thotë se kësaj here kanë votuar mjaft të tillë që zakonisht abstenojnë. Ka qenë edhe vota e protestës për dështimet e mëdha të qeverisë së kryeministrit Haradinaj (i cili është humbës më i madh i zgjedhjeve së bashku me Fatmir Limajn e Nismës). Haradinaj mezi e ka siguruar votën tradicionale në bastionet dhe këtë në koalicion me PSD-në, për të cilën do ta shohim se sa është dërrmuar ose zbehur pasi që të numërohen votat për deputet. Pastaj, shumë veta po më thonë se kanë qenë në mëdyshje kujt t'ia

rrja e madhe e votuesve të rinj



japin votën, Vjosa Osmanit apo Albin Kurtit, dhe duke qenë të bindur se koalicioni i tyre është i pashmangshëm, por u përcaktuan për Kurtin sepse kishin frikë se Vjosa nuk mund t'u bëjë ballë fraksioneve të LDK-së që në rrethana të caktuara dhe presione, do të hynin sërish në koalicionin me PDK-në. Në fitoren e Albin Kurtit mbase ka ndikuar edhe fushata me mjaft komoditet e LDK-së, e cila ishte e bindur se do t'i fitojë këto zgjedhje duke nënçmuar mobilizimin e jashtëzakonshëm të Kurtit.

"Epoka e re": PDK-ja si parti e tretë ka paralajmëruar shkuarjen në opozitë. Si e shpjegoni rënien e saj?

Maliqi: PDK-ja e ka filluar reformën mjaft rrënjësore të brendshme në momentet më kritike të rënies së përgjithshme të popullaritetit, të atribuimit të të gjitha mëkatëve të qeverisjes së saj 11-vjeçare dhe spastrimit të radhëve të saj nga personalitete me akuzë për korrupsion dhe nepotizëm edhe në rastet kur ata kanë qenë figura me

rëndësi që kanë siguruar shumë vota. Duke e pasur parasysh këtë, PDK-ja nuk ka kaluar keq, mund t'i ketë fituar rreth 25 deputetë dhe mbetet formacion më elektorat të rëndësishëm. Është aplauduar edhe për mënyrën se si e ka pranuar humbjen dhe kalimin dinjitoz në opozitë. Mendoj se do të luajë rol të rëndësishëm të opozitës konstruktive në proceset e rëndësishme që e presin Kosovën në periudhën e ardhshme.

"Epoka e re": Po ashtu, konstatuat se koalicioni AAK-PSD nuk ka dalë mirë në këto zgjedhje, kurse Nisma-AKR-PD nuk arritën ta kalojnë pragun. Pse ndodhi kjo?

Maliqi: AAK-ja është ndëshkuar për shkak të politikave mujshare dhe jo të menduara mirë të kryeministrit, kurse PSD-ja dhe Nisma sepse janë formacione të vogla që kanë dalë nga çarjet e partive. Asnjëra prej tyre nuk ka mbijetuar gjatë. AKR-ja që nga fillimi ka qenë një ballon parti e miliardit Pacolli e cila ka qenë në rrënjë të vazhdueshme

dhe mbahej në skenë falë akrobacioneve me koalicionet, tani është ndëshkuar mendoj përfundimisht.

"Epoka e re": Me këtë përbërje të Kuvendit, sa sfidues do të jetë krijimi i institucioneve të reja?

Maliqi: Për momentin nuk shihet ndonjë alternativë e koalicionit LV-LDK. Nëse ajo bëhet me baza të shëndosha programore dhe pa improvizime, duke respektuar maturinë e përvojën e LDK-së, por edhe vrullin për ndryshime të LV-së, mund të bëhet një kokej këndjellës për demokracinë e brishtë të Kosovës. Mendoj se faktori ndërkombëtar do ta marrë seriozisht zgjedhjen e elektoratit të Kosovës, por edhe Albinin me Vjosën, përkatësisht dy subjekte me kapacitetet që kanë, duhet të dëgjojnë me vëmendje sugjerimet e atyre faktorëve ndërkombëtarë që edhe na kanë mundësuar që të pavarësohemi, e tani kërkojnë që të krijojmë sistem stabil demokratik. Është vështirë e arritshme, por jo e pamundshme.

KMDLNj-ja: Zgjedhjet e parakohshme, shembull për rajonin

PRISHTINË, 7 TETOR - Këshilli për Mbrojtjen Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) nëpërmjet një komunikate për medie ka vlerësuar se zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit kanë përfunduar në mënyrë demokratike, me incidente të papërfillshme të cilat nuk kanë ndikuar as në ecurinë e procesit zgjedhor e as në rezultatet përfundimtare. "KMDLNj këto zgjedhje i konsideron si të organizuara mirë, të monitoruara shumë mirë dhe ndonëse ishte një kohë e shkurtër për organizimin e tyre, konsiderohen si zgjedhjet më të mira, me theks të veçantë e konsideron pozitive pjesëmarrjen e lartë të qytetarëve në këto votime, krahasuar me zgjedhjet e vitit 2017", është thënë në komunikatën e KMDLNj-së.

Sipas kësaj komunikate, KMDLNj-ja ka vlerësuar si shumë pozitive faktin që partitë jofituese nuk e kanë kundërshtuar rezultatit e zgjedhjeve e që e krijon një situatë më të lehtë për formimin e institucioneve të reja. "KMDLNj pret dhe thërrret që sa më parë të formohen institucionet e reja në mënyrë

që të mos lejohet stërzgjatja e një vakumi institucional. KMDLNj, gjithashtu, pret që të ulet retorika tensionuese për faktin se kanë përfunduar zgjedhjet dhe tensionimi i panevojshëm i situatës ndikon në funksionalizimin e institucioneve të reja, efektivitetin e punës dhe proceseve demokratike. KMDLNj pret që institucionet e reja t'u kushtojnë vëmendje të veçantë të drejtave të njeriut, pa bërë dallime në baza etnike, moshore, gjinore, bindjeve politike dhe statusit në shoqëri", është theksuar më tutje në komunikatë.

KMDLNj ka uruar fituesin e zgjedhjeve Vetëvendosjen dhe LDK-në, ndërsa nga partitë që do të mbeten në opozitë pret të luajnë një rol konstruktiv në interes të qytetarit dhe shtetit. "Në këtë kontekst, KMDLNj kërkon angazhim më të madh për grupet e marginalizuara. KMDLNj uron fituesin e zgjedhjeve - LV, por edhe LDK-në, ndërsa nga partitë që do të mbeten në opozitë pret të luajnë një rol konstruktiv në interes të qytetarit dhe shtetit", është thënë në këtë komunikatë.



Amerika zoton pesë milionë dollarë për shkatërrim të armëve konvencionale në Kosovë

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë zotuar edhe pesë milionë dollarë për pastrimin e mbetjeve të municioneve kasetore dhe të mbetjeve të tjera shpërthyes të luftës në Kosovë. Programi që është paraparë të zbatohet brenda viteve 2020-2023 do t'i kthejë popullit të Kosovës së paku 4.298.442 metra katrorë tokë të rrezikshme. Prej vitit 1996 deri në vitin 2019, programi i ShBA-së për shkatërrim të armëve konvencionale ka investuar më shumë se 9.7 milionë dollarë në mbështetje të përpjekjeve të Kosovës për ta adresuar trashëgiminë e municioneve kasetore dhe mbetjeve të tjera shpërthyes të luftës



PRISHTINË, 7 TETOR (ER) - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë zotuar edhe pesë milionë dollarë për pastrimin e mbetjeve të municioneve kasetore dhe të mbetjeve të tjera shpërthyes të luftës (ERË) në Kosovë. I paraparë të zbatohet brenda katër vjetëve (2020-2023), ky program pritet t'ia kthejë popullit të Kosovës së paku 4.298.442 metra katrorë tokë të rrezikshme. "Ky është

kontributi i vetëm më i madh i financimit për shkatërrimin e armëve konvencionale nga Shtetet e Bashkuara në Kosovë qëkur ShBA-ja filloi programin në Kosovë në vitin 1996. Ky kontribut do t'i adresojë vendet me ndikim të lartë që janë të kontaminuara me municione kasetore dhe ERË, duke ua kthyer përfundimisht tokën e kontaminuar me mbetje të minave tokësore autoriteteve

për ta adresuar me kapacitetin e tyre kombëtar", ka njoftuar Ambasada e ShBA-së në Kosovë.

Sipas këtij njoftimi, prej vitit 1996 deri në vitin 2019 programi i ShBA-së për shkatërrim të armëve konvencionale ka investuar më shumë se 9.7 milionë dollarë në mbështetje të përpjekjeve të Kosovës për ta adresuar trashëgiminë e municioneve kasetore dhe ERË. "Nga

tetori i vitit 2016 deri në qershor të vitit 2019 Shtetet e Bashkuara kanë mundësuar që popullit të Kosovës t'i kthehen 3.254.566 metra katrorë tokë. Deri në fund të vitit 2020 Shtetet e Bashkuara do të kenë kontribuar në kthimin e së paku 4.288.561 metrave katrorë tokë që nga tetori i vitit 2016.

Programi i Shteteve të Bashkuara për armë konvencionale në Kosovë zbatohet nga HALO Trust (TrusTit HALO) dhe Norwegian People's Aid (NPA) (Ndihma e Popullit Norvegjez) (NPA) me mbështetje të Qendrës së Kosovës për Veprim ndaj Minave", është thënë në këtë njoftim.

Ushtarët e FSK-së të gatshëm për garën ndërkombëtare 'Cambrian Patrol 19'

PRISHTINË, 7 TETOR - Një kontingjent i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) ka udhëtuar për në Britani të Madhe për të marrë pjesë në garën ushtarake ndërkombëtare "Cambrian Patrol 19", e cila do të mbahet deri më 21 tetor 2019.

Forca e Sigurisë e Kosovës, me qëllim të zbatimit të misionit të saj dhe me synim që të arrijë rezultate në përputhje me standardet e kërkuara bashkëkohore, në këtë ushtrim do të marrë pjesë në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Britaninë e Madhe. Gara "Cambrian Patrol 19" është aktiviteti më prestigjioz ushtarak që realizohet nga Brigada 160 e këmbësorisë dhe është ushtrim kryesor patrullues për ushtrinë e Britanisë i cili është i hapur për të gjitha shërbimet ushtarake të Britanisë dhe shërbimet e tjera ushtarake ndërkombëtare.

Këtë vit kontingjenti i FSK-së që nga muaji shkurt ka bërë për-



gatitje intensive si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri në disiplinën të ndryshme duke filluar nga faza përgatitore për këtë ushtrim, e cila ka zgjatur rreth 8 muaj të plotë ku janë përfshirë tre muaj parapërgatitje dhe pesë muaj trajnim intensiv.

Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës po marrin pjesë në këtë garë për herë të tretë dhe se FSK-ja për herë të parë ka marrë pjesë në këtë garë në vitin 2016 dhe në mesin e shumë shteteve pjesëmarrëse kontingjenti i saj pati marrë "medaljen e artë", ndërsa në garën e vitit 2018 kontingjenti i FSK-së ishte shpërblyer me "medaljen e bronzë".

Ushtrimi "Cambrian Patrol" ka filluar që nga viti 1959 dhe në mbarë botën njihet si një nga patrullat më të vështira, ku një numër i vogël skuadrash arrijnë të dekorohen me medalje, ndërsa shkalla e dështimit është mjaft e lartë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, model sa i përket menaxhimit informativ

PRISHTINË, 7 TETOR - Shqyrtimi i draft-rregullores për përdorimin e sistemit për menaxhimin informativ të lëndëve ishte pika kryesore e cila është diskutuar të hënën në mbledhjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

Menaxheri i lëndës, Fatmir Rexhepi, është shprehur se janë në fazën e fundit të implementimit të draft-rregullores dhe se

ky proces do të përfundojë deri në fund të muajit nëntor. Ai ka thënë se për këtë kanë marrë model përvojat e disa vendeve të rajonit dhe se ky sistem është treguar i suksesshëm.

Ndërsa sekretari i KGJK-së për çështje inovative, Armend Berisha, ka thënë se ky sistem po tregohet i suksesshëm edhe në gjykatat e Kosovës. Ai ka deklaruar se janë duke shërbyer

si model për shfrytëzimin e teknologjisë dhe se ka avancim të madh sa i përket kësaj çështjeje. Anëtarët e këtij këshilli në këtë mbledhje janë pajtuar që paneli për shqyrtimin e aplikacioneve për kandidatët për gjyqtarë në Divizionin e Gjykatës së Apelit në Mitrovicë të përbëhet nga Gyltene Sylejmani, Kujtim Paçuli, Nena Vllaçiq, Nehat Idrizi dhe Qerim Fazliu.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka publikuar rezultatet preliminare të zgjedhjeve të 6 tetorit

Rezultatet preliminare: LV-ja 31 deputetë, LDK-ja 30, PDK-ja 25 dhe AAK-ja 14

Sipas 98 për qind të rezultateve preliminare të zgjedhjeve të parakohshme të 6 tetorit, LV-ja ka fituar 25.56 për qind apo 200 754 vota, LDK-ja 24.87 për qind apo 195 296 vota, PDK-ja 21.14 apo 166 009 vota, AAK-PSD ka fituar 11.54 për qind apo 90 617 vota dhe Lista Serbe 6.69 për qind apo 52 529 vota. Kurse koalicioni Nisma-AKR-PD nuk ka mundur ta kalojë pragun zgjedhor duke marrë 4.89 për qind apo 38 433 vota. Bazuar në këto rezultate, LV-ja do t'i ketë 31 deputetë, LDK-ja 30, PDK-ja 25 dhe AAK-ja 14. Por këto rezultate nuk përfshijnë votat me kusht, me postë dhe votat e personave me nevoja të veçanta

Kurti është zotuar se gjatë mandatit të ardhshëm do të qeverisë së bashku me qytetarët e Republikës së Kosovës. "Qytetarët folën me votën e tyre. Ata ndërhyjnë masivisht në skenën politike në mënyrë që drama kosovare e shtetit të kapur të mos ketë fund tragjik. Urtësia e popullit tonë në çastet vendimtare ishte asgjë më pak sesa fantastike. Tash ne duhet të punojmë. Ama sërish bashkë me qytetarët. Kurrë anash apo prapa qytetarëve. Bashkë, gjithnjë. Punët e vështira që na presin vetëm sa ma shtojnë vullnetin. Ato nuk kanë llogari me neve, me juve, me mua. Sepse erdhi dita. Ju faleminderit të gjithëve dhe secilit!", ka theksuar Kurti.

Ndërkohë nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lufti Haziri, ka thënë se rezultati i tanishëm i zgjedhjeve parlamentare ia jep mandatin Lëvizjes Vetëvendosje për formimin e qeverisë. Ai ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se nuk do të nisin negociatat për qeverinë e re përdërisa nuk përfundon numërimi i të gjitha votave. "Rezultati është shumë i ngushtë dhe ne jemi duke e pritur numërimin e të gjitha votave, përfshirë votat me kusht, votat e diasporës dhe votat për deputetët, pastaj fillon procesi i negociatave. Dallimi është i vogël, një deputet, por që ia jep mandatin (për formimin e qeverisë) liderit të Vetëvendosjes", ka thënë Haziri.

PDK-ja ka qenë partia e parë që e ka pranuar humbjen. Lideri i kësaj partie, Kadri Veseli, ka thënë se PDK-ja do të kalojë në opozitë, por do të vazhdojë t'i shërbejë kombit dhe shtetit. "Qytetarë të Republikës së Kosovës së bashku me Partinë Demokratike të Kosovës kemi punuar shumë që t'i fitojmë këto zgjedhje, por nuk fituam. Qytetarët kanë dhënë verdiktin e tyre dhe ne e pranojmë. PDK-ja do të kalojë në opozitë, por ne do të vazhdojmë t'i shërbejmë kombit dhe shtetit", ka thënë Veseli në një konferencë për medie.

Kurse lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se vendimi i tij për t'ia kthyer sovranit vendimmarrjen, pikërisht në kohë udhëkryqi për Kosovën, u vërtetua që ishte veprim i drejtë. Ai ka thënë se gara e drejtë dhe e qetë e ka ngritur Kosovën dhe qytetarët e saj në një standard të ri të pjekurisë politike dhe demokratike, duke shërbyer si model shembull në rajon. Sipas Haradinajt, për këtë meritore janë të gjitha partitë politike, pa dallim. "Uroj që me të njëjtin nivel maturie, të mbyllet edhe ky cikël elektoral, duke hapur rrugë pa vonesa, konstituimit të Kuvendit dhe institucioneve të reja demokratike në vend. Kosovë, na presin sfida!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi,

ka uruar fituesin e zgjedhjeve të 6 tetorit. Ai ka thënë se ajo që ka ndodhur mbrëmë është fitore e demokracisë. "Urimi i parë shkon për sovranin i cili në zgjedhjet e 6 tetorit bëri zgjedhjen për ndryshimin e qeverisjes së vendit! Kjo është fitore e demokracisë. Urimi i dytë shkon për LV-në e cila doli parti e parë në këto zgjedhje. Natyrshëm urimi shkon edhe për kryetarin e LV-së e kandidatit për kryeministër, Albin Kurti! Urimi i tretë është për të majtën e cila për herë të parë doli partia fituese në zgjedhje! Të shpresojmë se zgjedhja është e duhura! E qytetari të jetë fitues!", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook".


Rezultatit e zgjedhjeve e ka pranuar edhe presidenti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli. Ai ka uruar qytetarët e Kosovës për procesin zgjedhor të 6 tetorit dhe liderin e Vetëvendosjes, Albin Kurti, për fitore. "Sovrani e tha fjalën e tij dhe ai ka gjithmonë të drejtë. Është për t'u përgëzuar populli i Kosovës që votoi me qetësi dhe maturi. Urime për udhëheqësit e opozitës që me koherencë, me etikë, e konfirmuan alternativën e tyre duke siguruar votim popullor të qartë. Përgëzoj zotni Albin Kurti për integritetin e tij politik dhe zonjën Osmani që krijoi energji të re mbi themelet e trashëgimisë rugoviste", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 7 TETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të hënën në uebfaqen e saj ka publikuar 98 për qind të rezultateve të zgjedhjeve të parakohshme të 6 tetorit. Këto rezultate preliminare e nxjerrin Lëvizjen Vetëvendosje (LV) fituese të zgjedhjeve me 25.56 për qind apo 200 754 vota. E dyta është renditur Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 24.87 për qind apo 195 296 vota. Kurse në vendin e tretë ka dalë Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 21.14 për qind apo 166 009 vota. Vendi i katërt i takon koalicionit parazgjedhor AAK-PSD me 11.54 për qind apo 90 617 vota. Ndërkaq Lista Serbe është renditur e gjashta me 6.69 për qind apo 52 529 vota. Kurse koalicioni parazgjedhor Nisma-AKR-PD nuk ka mundur ta kalojë pragun zgjedhor meqë ka marrë 4.89 për qind apo 38 433 vota. Por këto rezultate nuk përfshijnë votat me kusht, me postë dhe votat e personave me nevoja të veçanta. Megjithatë, bazuar në këto rezultate, LV-ja do t'i ketë 31 deputetë, LDK-ja 30, PDK-ja 25 dhe AAK-ja 14 deputetë. Këto rezultate pothuajse janë pranuar nga të gjitha subjektet politike. Për rezultatit e zgjedhjeve të hënën ka folur lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe kandidati për kryeministër, Albin Kurti. Ai ka thënë se fitorja bindëse e opozitës ka ardhur sepse qytetarët e deshën ndryshimin. "Prej

mbrëmë ka shpresë. Sepse dje pati guxim. Ju votuat masivisht duke bërë që opozita e deridjeshme të korrë fitore bindëse. Ndryshimi ndodhi. Dhe, jo vetëm kaq. Populli vendosi që këtij ndryshimi i prin dhe do t'i prijë Lëvizja Vetëvendosje. Të gjithë ju që keni votuar dje u jam falënderues që keni kryer detyrën qytetare e obligimin demokratik në një kohë të vështirë siç është kjo që po kalojmë dhe në një vend të dashur siç është Kosova jonë. Të gjithë ju që keni votuar për ndryshimin, e sidomos për Vetëvendosjen, ju jam mirënjohës për vetëdijen e lartë dhe ndërgjegjen e thellë për ta shpëtuar republikën tonë nga zvetënimi i mëtutjeshëm", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".



Liderët shqiptarë urojnë Kurtin për fitoren në zgjedhje

PRISHTINË, 7 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, është lideri i parë që e ka uruar kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosjes (LV), Albin Kurtin, për fitoren në zgjedhjet

e jashtëzakonshme parlamentare të 6 tetorit. Edhe presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka uruar qytetarët dhe klasën politike në Kosovë për kulturën e lartë

demokratike të cilën e kanë treguar gjatë zgjedhjeve të 6 tetorit. Edhe kryetari i Partisë Demokratike (PD), Lulzim Basha, ka uruar Vetëvendosjen dhe LDK-në

për rezultatit në zgjedhjet e 6 tetorit.

Edhe kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integritim (LSI), Monika Kryemadhi, i ka quajtur zgjedhjet në Kosovë

shembull të kulturës demokratike. Ajo ka uruar për zemërsisht gjithë drejtuesit e forcave politike për suksesin dhe sjelljet e tyre në këto zgjedhje.

OAK-u e shqetësuar për barrierat e bizneseve transportuese

PRISHTINË, 7 TETOR (ER) - Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) ka shprehur shqetësimin e saj për barrierat që po iu krijohen bizneseve transportuese të Kosovës nga autoritetet shqiptare në lidhje me tahografin. Në një komunikatë për medie, OAK-u ka njoftuar se ka pranuar një ankesë nga anëtar i saj, biznesi "RONEX", i cili është gjobitur me 800 euro për tahograf të kamionit, edhe pse autoritetet shqiptare janë të informuara se Kosova dhe operatorët transportues kosovarë nuk kanë mundësi të pajisen me kartelë digjitale për shoferët profesionistë pasi vendi ynë nuk është pjesë e organizatës botërore të transportit TIR.

OAK-u përkujton se me protokoll të mirëbesimit bizneset e Kosovës janë të lira nga një kërkesë e tillë në Shqipëri dhe disa vende të rajonit. Për më tepër, Oda e Afarizmit të Kosovës ka theksuar se ky nuk është rasti i fundit ku kompanitë gjobiten nga autoritetet shqiptare që transportojnë mallra nga Porti i Durrësit dhe një barrierë tjetër është edhe kufizimi që u bëhet për faktin se në rezervuarët e



kamionëve duhet të kenë vetëm 200 litra derivate në momentin që ata hyjnë në Shqipëri.

Bizneset kanë pohuar se asnjë praktikë ndërkombëtare dhe rajonale nuk e ndalon që mos të ketë derivate në rezervuarin e kamionit me sasinë që e lejon prodhuesi sasi kjo që varion nga

400 deri 800 litra. Në këtë rast kamionët nga Kosova nuk guxojnë që në rezervuarët e tyre të kenë sasi derivati mbi 200 litra, pasi përndryshe do të gjobiten dhe iu konfiskohen patentëshoferët vozitësve. Në këtë kontekst, OAK-u ka konsideruar se barrierat që po u bëhen bizneseve transportuese të

Kosovës po e vështirësojnë operimin e tyre dhe me këtë rast iu bënë thirrje autoriteteve shqiptare të kenë parasysh marrëveshjet paraprake dhe marrëveshjet Kosovë - Shqipëri, në mënyrë që ato të mos mbesin vetëm në letër, por të gjejnë zbatim praktik, në mënyrë që barrierat e panevo-

jshme që po iu krijohen bizneseve të tejkalohen.

Në lidhje me këtë rast, OAK-u i është drejtuar me një letër Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë së Infrastrukturës, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë.

Bosnja e Hercegovina pret heqjen e tarifës 100 për qind nga Kosova

PRISHTINË, 7 TETOR (ER) - Ministri i Tregtisë në Bosnje e Hercegovinë, Mirko Sharović, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, si dy forcat më të mëdha politike që dolën nga zgjedhjet e 6 tetorit në Kosovë, pritet që t'i qetësojnë raportet rajonale. Ai ka thënë se para së gjithash Bosnja pret heqjen e tarifës ndaj mallrave të saj. "Menjëherë pas formimit të qeverisë unë pres heqjen e tarifave. Derisa kjo nuk ndodh, atëherë do të ketë komplikim të raporteve brenda CEFTA-së, por edhe në përgjithësi në rajon", ka thënë Sharović.

Edhe kryetari i Odës Ekonomike të Bosnjës e Hercegovinës, Nemanja Vasiq, ka thënë folur për heqjen e tarifave për mallrat nga ky vend. Në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", Vasiq ka thënë se është mirë që klima politike në Kosovë po ndryshon dhe se kjo mund të çojë në eliminimin e tarifave. "Sipas deklaratave të para të fituesve, pritet që ato të shkojnë drejt heqjes, por, gjithashtu, është e qartë se do të ketë kushte të



reja politike. Kjo është ende në sferën e politikës", ka thënë Vasiq.

Tarifat prej 100 përqindësh për mallrat nga Bosnja dhe Serbia u vendos nga Qeveria e

Kosovës në nëntor të vitit 2018. Në këtë mënyrë, eksporti i këtyre dy vendeve në Kosovë u ndal pothuajse plotësisht. Kjo ka bërë që të ndërpritet edhe dialogu ndërmjet Kosovës dhe

Serbisë që zhvillohej përmes lehtësimit nga ana e Bashkimit Evropian. Në arsyetimin e saj, Qeveria e Kosovës kishte thënë se Bosnja e Hercegovina dhe Serbia duhet ta njohin

pavarësinë e Kosovës. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë bërë disa herë thirrje për heqjen e tarifave, në mënyrë që të vazhdojë dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

BPV-ja shënoi rritje reale për 4.13 për qind

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), Bruto Produkti Vendor (BPV) në tremujorin e dytë (TM2) të vitit 2019 shënoi rritje reale për 4.13 për qind, në krahasim me TM2 të vitit 2018. "Rritja reale e BPV-së, sipas aktiviteteve ekonomike, është si vijon: aktivitetet financiare dhe të sigurimit 22.4 për qind; aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike si dhe aktivitetet e shërbimeve administrative dhe mbështetëse 8.95 për qind; artet, argëtimi dhe çlodhje, si dhe aktivitetet e prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera 8.8 për qind; ndërtimtaria 6.9 për qind; industria nxjerrëse, përpunuese, energjia elektrike, gaz, avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar, furnizimi me ujë, si dhe aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave dhe rehabilitimit 6.7 për qind, nga të cilat industria përpunuese 10.6 për qind; tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, transporti dhe magazinimi, aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor 6.5 për qind; aktivitetet e pasurive të paluajtshme 3.6 për qind"



mbështetëse 8.95 për qind; artet, argëtimi dhe çlodhje, si dhe aktivitetet e prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera 8.8 për qind; ndërtimtaria 6.9 për qind; industria nxjerrëse, përpunuese, energjia elektrike, gaz, avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar, furnizimi me ujë, si dhe aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave dhe rehabilitimit 6.7 për qind, nga të cilat industria përpunuese 10.6 për qind; tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automjeteve

dhe motoçikletave, transporti dhe magazinimi, aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor 6.5 për qind; aktivitetet e pasurive të paluajtshme 3.6 për qind", është thënë në raportin e ASK-së, duke u shtuar se rënie reale kishte tek administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi social i detyrueshëm, arsimit, shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale (-1.1 për qind); bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (-0.3 për qind). "Ndërkaq, BPV sipas qasjes së shpenzimeve ka pasur rrit-

je në: eksportin e mallrave dhe shërbimeve me 14.3 për qind; formimin e bruto kapitalit me 4.1 për qind; shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe institucionet jopërfituese në shërbim të ekonomive shtëpiake (IJP-SHESH) me 0.1 për qind. Rënie reale kishte në të dhënat e: shpenzimeve të konsumit final të Qeverisë (-3.2 për qind); importit të mallrave dhe shërbimeve (-0.5 për qind), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit", thuhet në raportin e ASK-së.

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 TETOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar raportin e "Bruto Produktit Vendor" (BPV) për tremujorin e dytë (TM2) 2019, sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve me çmime aktuale dhe kon-

stante. Sipas ASK-së, BPV-ja në TM2 të vitit 2019 shënon rritje reale për 4.13 për qind, në krahasim me TM2 të vitit 2018. "Rritja reale e BPV-së sipas aktiviteteve ekonomike është si vijon: aktivitetet financiare dhe të sigurimit 22.4 për qind; aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike, si dhe aktivitetet e shërbimeve administrative dhe

Gratë e Krushës marrin mbështetje nga Klubi i Grave Ndërkombëtare



Krushë e Madhe, 7 tetor (ER) - Një shoqatë ndërkombëtare që rreth vetes përbën vetëm gra, kanë qendruar të hënën në Krushë të Madhe të Rahovecit ku kanë viz-

ituar gratë e Krushës. Ky delegacion i International Women Club (Klubi i Grave Ndërkombëtare) kanë vizituar kompaninë "Gratë e Krushës" që udhëhiqet nga Fahrrije

Hoti nga ky fshat. Kompania "Gratë e Krushës" është themeluar pas luftës në Kosovë ku merret me përpunimin e specave që kultivohen me të madhe në Krushë.

Prodhimet e tyre nga specat plasohen në treg të Kosovës, por edhe jashtë saj. Krusha e Madhe është një fshat i Komunës së Rahovecit ku shumica e meshkujve të rritur

të këtij fshati ishin vrarë në marsin e vitit 1999 nga forcat paramilitare serbe. Fshati pati mbetur vetëm në gra dhe fëmijë dhe profesioni kryesor i tyre është bujqësia.

PAS FITORES, LV-së I MBETET EDHE TË TRANSFORMOHET

Nëse i mban aktive prirjet hakmarrëse ndaj kundërshtarëve politikë dhe ideologjikë, po edhe ndaj faktorëve ndërkombëtarë ashtu siç i kishte ndër vite, LV-ja mund të shkaktojë polarizime dhe konflikte serioze në politikë e në shoqëri



Shkruan: Milazim
KRASNIQI

Zgjedhjet e 6 tetorit 2019 sollën ndryshimin e roleve të partive kryesore politike. Dy partitë opozitare, LV-ja dhe LDK-ja, i fituan zgjedhjet, ndërsa partitë që ishin në qeverisje, PDK, AAK

dhe NISMA, i humbën ato. Shkaqet e ndryshimit janë të shumta. Disa prej tyre i heqin fillet që nga pozita neokoloniale e Kosovës në raport me faktorin ndërkombëtar. Ndërsa, disa të tjera nga qeverisja e tejzgjatur e një partie (PDK-ja) nga arroganca e ish-disa pushtetarëve, nga keq-qeverisja, nga ndryshimet demografike, nga ndryshimet e pritshmërisë së qytetarëve etj. Sidoqoftë, rezultati është ky që është, një përmbyesje e koalicionit të deritashëm qeverisës dhe hapja e mundësisë për një qeveri të re, të udhëhequr nga LV-ja.

Prandaj, që nga dita e sotme kureshtja mbetet e lartë lidhur me qeverinë e re dhe drejtimet e politikave të saj, kur dihet se LV-ja në opozitë ka përdorur dhunën ndaj institucioneve, individëve dhe pronës shtetërore e private, si mjet brutal për arritjen e qëllimeve politike. Mbetet të shihet se a do të heqë dorë LV-ja nga dhuna, tash që i ka realizuar qëllimet politike me anën e zgjedhjeve. Në këtë kontekst, bindja ime është se po të mos e përdorte dhunën ashtu si e përdori, një dhunë lemeritëse dhe shkatërruese për imazhin e vendit, LV-ja e ka pasur

rrugën të hapur të vinte në pushtet në vitin 2017, por pikërisht taktikat e dhunës e patën lënë jashtë qeverisë në atë vit. Në zgjedhjet e 6 tetorit LV-ja përdori taktika krejt të tjera, u shpërfaqë si parti e moderuar, hoqi dorë nga elementët kryesorë të programit të vet dhe kjo e ndihmoi të dilte fituese. Por, tash i mbetet që të bëjë një deklaratë distancuese nga dhuna si mjet për arritjen e qëllimeve politike, që ta finalizojë fitoren dhe ta skicojë një program të besueshëm qeverisës. Këtë gjë duhet ta bëjë para se ta marrë mandatin qeverisës sepse mundësia e përdorimit të dhunës si parti qeverisëse është shumë më e madhe sesa kur ishte në opozitë. Nëse i mban aktive prirjet hakmarrëse ndaj kundërshtarëve politikë e ideologjikë,

po edhe ndaj faktorëve ndërkombëtarë, ashtu si i kishte ndër vite, LV mund të shkaktojë polarizime dhe konflikte serioze në politikë e në shoqëri. Në këtë kontekst, besoj se partneri potencial i saj, LDK-ja, e ka për obligim t'ia kërkojë LV-së një aso deklaratë, pasi pikërisht kreu i LDK-së, Isa Mustafa, ka qenë caku kryesor i sulmeve të dhunshme në vitet kur ishte kryeministër. Nëse LDK hyn në koalicion me LV me atë kompleks inferioriteti, ajo kurrë nuk do të arrijë ta frenojë mujsharinë revolucionare të LV-së dhe veçmas ambicien problematike të kreut të saj. Në atë rast LDK-ja do të duket si patericë e LV-së, siç ishte edhe PDK-ja si patericë e Ramush Haradinajt, në qeverinë së cilës sapo iu dha lamtumira.

Komuna e Drenasit është duke hartuar Planin Lokal të Veprimit në Mjedis

DRENAS, 7 TETOR (ER) - Komuna e Drenasit ka bërë me dije se është duke hartuar Planin Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) për vitet 2020-2025, ku këtë plan e ka prezantuar në sallën e Kuvendit Komunal. Në njoftimin e Komunës së Drenasit është thënë se këtij drafti tani i mungon pjesa e përcaktimit të aktiviteteve, afatëve kohore dhe përgjegjësve për implementim, për çfarë edhe janë thirrur grupet punuese, në të cilën ka përfshirje edhe shoqëria civile, në mënyrë që këtij plani t'i shtohen pikat konkrete, përmes vërejtjeve, sugjerimeve, propozimeve në afat sa më të shkurtër kohor. "Ky plan gjatë ditëve në vijim do të plotësohet me të dhëna të përditësuara nga grupet punuese, sidomos ata institu-

cionalë, duke përfshirë edhe shoqërinë civile si aktor kontribuues në hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për Komunën e Drenasit. Në përmbyllje të këtij drafti, pas ndryshimeve dhe plotësimeve të lartcekura që duhet të bëhen, më pas do të ketë debat publik me qytetarë që t'i japin vërejtjet, komentet e sugjerimet, në mënyrë që plani të jetë sa më profesional dhe që të kontribuojë në përmirësimin e mjedisit në Komunën e Drenasit për vitet 2020-2025", ka njoftuar kjo komunë. Sipas këtij njoftimi, në ditët në vijim opinioni publik do të njoftohet për mbajtjen e debatit publik, përkatësisht kohën dhe vendin ku do të diskutohet për Planin Lokal të Veprimit në Mjedis për Komunën e Drenasit.



Muharremaj: Projektet në Suharekë do të realizohen sipas planifikimeve

Suharekë, 7 tetor (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka mbajtur një takim me drejtorët e kësaj komune me të cilët ka biseduar për realizimin e projekteve të ndryshme. Me këtë rast, Muharremaj ka bërë me dije se projektet në këtë komunë do të realizohen sipas planifikimeve

buxhetore. Në këtë kontekst, ai ka thënë se do të angazhohen seriozisht për realizimin e projekteve dhe kërkesave të qytetarëve. "Puna vazhdon. Projektet do të realizohen sipas planifikimit buxhetor, natyrisht edhe me angazhimin tonë serioz", ka thënë Muharremaj.

Një pikë kthese në historinë e Kosovës

Për herë të parë në Kosovë fitojnë dy parti në zgjedhjet parlamentare, të cilat nuk drejtohen nga ish-luftëtarët e rezistencës. Të dyja kanë njoftuar se duan të bëjnë koalicion me njëra-tjetrën



Nga Michael MARTENS,
*Frankfurter Allgemeiner
Zeitung*

Kosova, shteti më i ri në Europë, ka nisur një ndryshim të madh të pushtetit. Për herë të parë, në ish-provincën serbe u zgjodh një parlament në vitin 2011, në atë kohë vendi ishte ende nën mbikëqyrjen e Kombeve të Bashkuara. Të gjitha votimet prej atëherë kanë pasur një të përbashkët: në fund, në një mënyrë a tjetër, gjithmonë në pushtet ishte një parti e dalë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. UÇK u shfaq në mesin e viteve '90 me qëllim rezistencën ndaj pranisë së shtetit serb në Kosovë. Ata e mbronin veten kundër sundimit të dhunshëm të Beogradit me mjete terroriste,

sulmonin ushtarët, oficerët e policisë dhe përfaqësuesit e tjerë të pushtetit serb. Fitorja e saj erdhi në vitin 1999 kur arritën të tërheqin NATO-n në konflikt. Në përfundim të luftës ajrore gati tremujore të NATO-s kundër Serbisë së Slllobodan Millosheviç, trupat serbe u detyruan të tërhiqen nga Kosova.

Shumë komandantë të UÇK-së formuan partitë e tyre në atë kohë, për të siguruar politikisht fuqinë e tyre në shtetin e ngritur gradualisht nën mbikëqyrjen e Kombeve të Bashkuara. Më të suksesshmit ishin Hashim Thaçi dhe 'Partia Demokratike' e tij dhe Ramush Haradinaj me 'Aleancën për Ardhmërinë'. Fillimisht, Thaçi dhe Haradinaj ishin mjaft popullorë mes shqiptarëve të Kosovës. Ata festoheshin si çlirimtarët nga zgjedha serbe.

Por sidomos pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, zhgënjimi u rrit. Gjithmonë e më shumë kosovarët kishin përshtypjen se ish-rebelët zyrtarë të UÇK-së po abuzonin padrejtësisht me shtetin e ri si një dyqan vetë-shërbimi për veten dhe

klanet e tyre. Përmes taktikave të zgjuara dhe aleancave të ndryshueshme, kampet e vjetra siguronin vazhdimisht që të mbeteshin në pushtet.

Por të dielën nuk mjaftonte më. Edhe pse nuk ishin numëruar të gjitha votat, dukej e sigurt, ose të paktën e mundur që qeverinë e re në Prishtinë ta dominonin dy parti që nuk kanë dalë nga UÇK-ja.

Një forcë politike me të vërtetë e re dhe e veçantë është partia 'Vetëvendosje' e ish-drejtuesit të studentëve, Albin Kurti. Ai ka patur në fund të viteve '90 lidhje me UÇK-në dhe mendimtarin e saj politik, Adem Demaçi. Por ai nuk ka qenë kurrë komandant luftëtarësh. Mbi të gjitha, ai nuk i përket klikës që prishi lavdinë e luftëtarëve pas përfundimit të luftës duke plaçkitur Kosovën. Edhe Vjosa Osmani, kandidatë kryesore e 'Lidhjes Demokratike të Kosovës' konsiderohet e pastër. Në sondazhe, ajo dhe

partia e saj ishin pak përpara 'Vetëvendosjes'. Pas zgjedhjeve duket se ajo qëndron pas. Osmani dhe Kurti e kanë bërë të qartë përpara zgjedhjeve se duan të bëjnë koalicion me njëri-tjetrin. Qëllimi kryesor është lufta kundër korrupsionit dhe nepotizmit, dhe si parakusht një reformë e gjyqësorit duke përfshirë rishikimin e plotë të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve (veting). Duket se tani ata mund të ndjekin fjalët e tyre në fushatën zgjedhore për t'i kthyer në vepra në pushtet.



Triumfi i Albinit, një leksion edhe për ne



Andi BUSHATI

Fitorja sfiduese e Albin Kurtit në zgjedhjet e 6 tetorit ka një rëndësi shumë më të madhe sesa ajo e çlirimit të vetëm Kosovës nga kapësit e shtetit. Në një rajon si ky yni, ku është shumë e vështirë të triumfosh në një garë elektorale, pa qenë pjesë e pushtetit, pa shpërndarë vende pune, pa bërë për vete policinë dhe aparatit e sigurisë, pa pasur nga mbrapa financimet e biznesmenëve që i ke ushqyer me para publike, pa u kuruar nga mediat që në pjesën më të madhe shkojnë pas pushtetit, një rezultat si ai i Vendvendosjes merr një rëndësi të veçantë.

Pas kësaj gjithkush është i lirë të mendojë: "PO, është e mundur". Është e mundur që ashtu si ky grupim i dalë në skenë një dekadë e gjysëm më parë, po ishe i armatosur me parime të forta, i pa korruptueshëm nga të gjithë pazarxhinjtë që të dalin përpara në një rrugë të gjatë, i ndërjegjeshëm se gjërat e mëdha nuk ndërtohen nën ankthin e shpejtësisë, i qartë për objektivat dhe i pakompromis me mjetet për ti realizuar ato, suksesi nuk mbetet një mollë e ndaluar.

Këtë ka bërë dalëngadalë dhe me durim Vetëvendosja. Kur të gjithë të tjerët nxitonin, nën ethet e shfrenuara ultraliberale, të privatizonin gjithçka, ajo nënvizonte efektet anësore të kësaj batërdie dhe solidarizohej me viktimat e saj. Kur të gjithë rendnin të afishoheshin si miq të korporatave dhe këmbenin privilegje me oligarkët, ajo denonconte shtetin e kapur. Kur të gjithë lëpinin buzët duke shijuar "Plazmon" keksat, ajo mbronte produktet made in Kosova. Kur të

gjithë hajnat ishin të gatshëm të thërrisnin "Amelika, Amelika", me shpresën se servilizmi ndaj diplomatëve të vendit më të fuqishëm në botë do ti pastronte nga mëkatet lokale, ajo nuk nguronte ti thoshte të vërtetën edhe të parëve edhe të dytëve.

Kur të gjithë ishin të gatshëm të falnin troje dhe teritore për të zgjatur me copëza Kosove kariere të tyre, ajo se kishte për gjë të shndërrohej në një formacion paramilitar, për ti penguar ata.

Më në fund kjo rrugë e vështirë i dha frytet e saj

Mësimi i madh i kësaj feste demokracie është se edhe në vende si tonat, ndonëse me vështirësi, një politikë e sinqertë, parimore dhe e vendosur mund të përkraket nga popullata, pa pasur nevojë për avantazhet mesquine që të jep qenia në pushtet. Mësimi i dytë edhe më i rëndësishëm është se edhe një forcë e konsideruar nga kastat në fuqi si ekstremiste dhe e dhunshme,

mund të bëjë për vete pjesën më të madhe të elektoratit. Për 15 vite me radhë, ne çfarë nuk kemi dëgjuar për ata djem, që herë i krahasonin më Trockin e herë me Ce Guevarën, teksa i shihnim të përmbysnin makinat e UNMIK-ut, të njollosonin me bojë selitë e ndërkombehtarëve, të lanin me gjakun e militantëve të tyre rrugët e Prishtinës, të ndalonin në kufi kamionët e Serbisë, të sfidonin prangat si Albini, apo të përflaknin parlamentin me bomba tymuese.

Ne i kemi parë hap pas hapi të mos bien dakord me Rambujenë, të mos pranojnë bisedimet e Vienës, të hedhin poshtë Athisarin, të bëjnë betejë për asosacionin, të xhindosen për demarkacionin me Malin e Zi dhe ti shpallin luftë tregtarëve që bëjnë biznes me kufijtë.

Për të gjitha këto u është dashur të mbajnë mbi shpinë, për një kohë të gjatë, etiketën e dhunuesve radikalë që ta ngjisin me cinizëm të gjithë ata që duan më shumë rehatinë vetjake sesa miqenien e

përbashkët.

Por, triumfi i tyre sot tregon se edhe përdorimi i dhunës ndaj pushteteve të dhunshme edhe aktet radikale kundër elitave të korruptuara edhe papajtueshmëria ekstreme me sharlatanët që i shërbejnë çdo rregjimi, në vend të dënohen, shpërblehen një ditë. Mjafton që as dhuna, as radikalizmi mos jenë armë të verbëra për të larë hesapet e së shkuarës, por katalizatorë për të thurur ëndrrat e së ardhmes, që ato të përkraken nga njerëzit që janë në prag të humbjes së shpresës.

Pikërisht ky është mësimi i dytë që na vjen historia e Albinit dhe e bandës së tij. Ajo na tregon se edhe në mjedise ku duket se çdo vlerë është zhbërë, ku çdo ideal ka humbur, ku rruga e vetme ka mbetur arratia, ekzistenca e një force idealiste si Vetvendosja mund të ndryshojë gjithçka. Pikërisht për këtë, fitorja e saj në këto zgjedhje nuk ka rëndësi vetëm për Kosovën, por për të gjithë vendet përreth, që janë të ngjashme me të./mapo.al

PDK DHE AAK-PSD DUHET TA VOTOJNË QEVERINË KURTI PA ASNJË KUSHT!



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Kaluan ethet zgjedhore: Zgjedhjet e 6 tetorit përfunduan si më mirë, pa probleme dhe duke u respektuar vullneti i votuesit - qytetarit. Ishin do befasi por, të cilat, me një analizë jo fort të thellë, do të konsideroheshin si përfundim normal dhe real e jo befasi. Në shkrimin për gazetën "Epoka e Re" të datës 5 tetor 2019 kam dhënë dy parashikime të rezultateve e që i kam ndërlidhur me përqindjen e atyre që do të votojnë: 1) nëse në këto zgjedhje do të dilnin 35 ose pak më shumë se kjo shifër, PDK-ja do të ishte fituese, LDK-ja e dyta, kurse LV-ja e treta. Nëse në zgjedhje do të dilnin 42 për qind e më shumë, fituese e padiskutueshme do të jetë LV-ja, e dyta LDK-ja, kurse në vendin e tretë do të ishte PDK-ja. Ashtu edhe doli. Gjithashtu kam parashikuar se Nisma pa AKR-në e kalon pragun pa asnjë problem, kurse Nisma me AKR-në nuk e kalon. Në momentin kur doli se në zgjedhje kanë votuar mbi 44 për qind, nuk kam pasur dilema për fituesin, për të dytin dhe të tretin. Kur u bënë publike 15 për qind të votave nga KQZ-ja e kam uruar Albulena Haxhiun dhe Glaukun për fitore, kurse Albinin jo sepse nuk kam pasur numër të telefonit, ndërkohë që nuk kam fare faqe në rrjetet sociale. Pas zgjedhjeve është thuaja normale që të gjithë deklarohen si fitues andaj e kuptoj Abelardin. Kadri Veseli bëri mirë që menjëherë i pranoi rezultatet dhe u deklarua se do të kalojë në opozitë. Besoj shumë opozitë konstruktive. Mendoj se të gjithë liderët e partive politike është dashur ta urojnë Albin Kurtin për fitore dhe ky është testi më i mirë i demokracisë. Për më keq, edhe pas fitores disa media u munduan ta njollosin Albin Kurtin duke e ndërlidhur me Rusinë dhe Serbinë dhe duke e vënë në pozitë se qenka kundër Perëndimit. Unë me Albinin një kohë të gjatë nuk kam pasur ndonjë afri politike, mirëpo asnjëherë nuk e kam mohuar patriotizmin, trimërinë, intelektualizmin dhe njohuritë politike. Dhe, në asnjë rast nuk e kam vënë në dyshim gatishmërinë e tij për sakrificë.

Pse fitoi LV-ja dhe pse nuk fituan LDK-ja, PDK-ja, AAK-PSD dhe Nisma-AKR:

1. Lëvizja Vetëvendosje: LV ishte shumë këmbëngulëse për realizimin e qëllimeve dhe me mjeshtëri e materializoi çdo gabim të kundërshtarëve politikë. Fitorja e LV-së mund të konsiderohet si fitore personale e Albin Kurtit i cili që nga rezistenca studentore kundër Serbisë, si sekretar i Zyrës së Përfaqësuesit Politik të UÇK-së që udhëhoq nga Baca Adem Demaçi, burgjeve në Serbi, përmes protestave ndaj UNMIK-ut, EULEX-it dhe partive kosovare në pozitë, më shumë e kaloi kohën duke u keqtrajtuar nga policia dhe politika sikur edhe në burgje sesa që kaloi me familjen dhe familjarët. Fillimisht e kundërshtoi procesin e decentralizimit, demarkacionit, Gjykatën Speciale, bisedimet pa kushte me Serbinë. Albin Kurti, duke ofruar tema sociale e në kushte të një papunësie ekstreme, kryesisht të rinjve dhe bashkimin kombëtar, fitoi përkrahjen e të rinjve sikur edhe patriotëve që ishin sakrifiku për bashkim kombëtar. Pasuesit e Albin Kurtit ishin fanatikë, të gatshëm për sakrificë dhe të gatshëm të punojnë si vullnetarë, në çdo kohë dhe në të gjitha kushtet. Albini e preku dellin e duhur duke punuar me diasporën në kohën kur askush nga liderët e tjerë nuk u takua me diasporën. Dhe, për dallim nga të tjerët, Albin Kurti kishte një oratori të jashtëzakonshme krahasuar me të tjerët e që e bënte të dominojë thuaja në të gjitha debatet. Kur Hashim Thaçi, në vend të kafesë së mëngjesit na servonte ndryshimin e kufijve dhe këmbim të territoreve me Serbinë, Albini dhe LV-ja, por edhe AAK-ja, ishin të pakompromis, pa lënë, për dallim nga të tjerët, asnjë mëdyshje. Albin Kurti dhe LV-ja dëshmuar se kanë kapacitet të jashtëzakonshëm organizativ e sidomos regjenerativ kur u larguan 12 deputetë që tashmë e blenë partinë nga Kaçusha Jashari. Të gjithë menduan se e pati puna e Albinin dhe LV-së por, doli e kundërta, LV-ja u forcua edhe më shumë. Po të mos ishin bisedimet me Serbinë dhe kushtëzimi që iu bëhet nga ndërkombëtarët, fitorja e LV-së do të ishte e madhe, në rastin e rrethanave ekzistuese llogaritet si fitore e Pirros. Sido që të jetë, me Albin Kurtin mund edhe të mos pajtoheni, por duhet ta respektoni për faktin se ai ka kurriz dhe nuk iu nënshtrorhet presioneve që e dëmtojnë interesin e kombit dhe të shtetit, në asnjë rrethanë dhe me asnjë kusht. Është i

pazëvendësueshëm në bisedime me Serbinë!

2. Lidhja Demokratike e Kosovës:

Asgjë nuk i bashkon me LV-në dhe Albin Kurtin, as e kaluara kombëtare e politike, as gatishmëria për sakrificë e as që kanë kapacitet vendimmarrës, si Albini. E vetmja çështje që i ka bashkuar dhe që e kanë arritur është, pse mos ta themi, jo mosdurim, por urrejtje e hapur ndaj PDK-së. LDK-ja tërë fushatën zgjedhore e ka ndërtuar kundër PDK-së dhe kraut të luftës dhe tërë shpresën e ka varur te Vjosa Osmani duke menduar se si një femër e dalluar do ta bëjë diferencën me të tjerët dhe do t'i fitojë zgjedhjet e që nuk doli të jetë ashtu. Gabimi tjetër i LDK-së ishte se manipulonte me Ibrahim Rugovën dhe vrasjet e pasqarura pas luftës që i konsideron politike, pa bërë asnjë hetim. Në këtë kontekst e bëri listën shumë nepotiste. Isa Mustafa e bëri një lojë edhe me Lutfi Hazirin edhe me Vjosa Osmanin duke ua dhënë mundësinë të cilën nuk e materializuan. LDK-ja nuk kishte fushatë të duhur, kishte fjalor përjashtues dhe të dhunshëm që nuk shkonte me këtë parti. Pavarësisht se doli e dyta, LDK-ja ka pozicion të fuqishëm negociues, pa LDK-në as që mund të bëhet Qeveria e as Albin Kurti kryeministër. Po të ishte Begja në vend të Isa Mustafës, në këtë situatë do t'ia rruante LV-së 70-80 për qind të ministrive. LDK-së ia humbën zgjedhjet Gjilani, Ferizaj dhe Mitrovica. Kam një bindje se një numër i votuesve të LDK-së, por edhe disa struktura të LDK-së ndihen të terrorizuar nëse Qeverinë e udhëheq Albin Kurti. Por pushteti ju ndërron shumë, prandaj edhe humbja është fort e dhimbshme. Koalicioni LV-LDK, nëse merren vesh, mund të bëjë punë të mira. Por të mos ngutemi, le të presim. Për LDK-në është e rëndë që nuk e ka fituar asnjë post kryesor; president është Hashim Thaçi-Shima, kryeministër Albin Kurti sikur që LV e ka edhe kryetarin e Kuvendit të cilin mund t'ia jap LDK-së si dhuratë për koalicion. Në këtë rast, ky post nuk do të ishte i fituar nga LDK-ja, por do të ishte i falur nga LV-ja. Albini parashikoi drejt: Albini kryeministër, Vjosa Osmani kryetare e Kuvendit.

3. Partia Demokratike e Kosovës:

Krahasuar me zgjedhjet e fundit nuk ka rënie, por rritje. Krahasuar me disponimin kundër saj, thuaja gjeneral, del të ketë kaluar shumë mirë. Në të gjitha shkrimet e mia në dy muajt e fundit kam thënë se po të isha në vend të Kadri Veselit do të kaloja në opozitë pavarësisht prej rezultateve. PDK-ja humbi zgjedhjet

sepse u mishërua në pushtet dhe mendonte se është e parapaguar për pushtet. PDK-në e ka dëmtuar shumë demarkacioni, Gjykata Speciale dhe Hashim Thaçi me idenë për korigjim të kufijve. PDK-ja e kishte organizimin e mirë në terren, bëri fushatë të mirë, listat ishin mjaft të mira hiç këtu disa persona të stërshpenzuar, të korruptuar dhe kompromituar sikur edhe përpjekjeve për ta legalizuar trashëgiminë familjare. PDK-ja ishte parti me dy kryetarë, Kadri Veselin me letra, kurse Hashim Thaçi me forcë dhe ndikim. PDK-ja humbi shumë për faktin se e humbi besimin te partitë e tjera, sidomos të LDK-ja e që po i hakmerret. Për mendimin tim, hiç këtu humbjen e pushtetit edhe në mandatin e kaluar nuk kishte ndonjë pushtet, PDK-ja është fituese strategjike shkaku se, ndonëse është shumë kontribuuese për disa procese që e kanë dëmtuar dhe e dëmtojnë Kosovën, tash si opozitë po lahet nga çdo përgjegjësi duke ua lënë LV-së dhe LDK-së nëse merren vesh për bashkëqeverisje, këmbët e Hashimit. Nuk kam dyshim se PDK-ja do të jetë opozitë konstruktive nëse pozita sillet mirë. Nëse pozita do të përpiqet të hakmerret atëherë Qeveria nuk do të ketë jetë të gjatë për faktin se do të bllokohej nga partitë që kanë kapacitet të madh destabilizues. Shpresoj të mos ndodhë kështu.

4. AAK - PSD: Nuk i përmbushi pritjet e mia. Kam qenë i bindur se do të përfundojë në vendin e katërt, por se do të ketë së paku 17-18 për qind të votave. Arsyet e kësaj rënie janë demarkacioni me Malin e Zi dhe koalicioni me PSD-në. Po të shkonte e vetme, sigurisht se do ta kalonte 15 përqindëshin e votave. Megjithatë AAK-ja, me taksën 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnja, e sidomos me kundërshtimin e idesë së boshtit Vuçiq - Thaçi dhe Rama për ndryshim të kufijve, duke kundërshtuar vendosmërisht aventurierët e Brukselit, Mogherini dhe Johannes Han, ka penguar realizimin e kësaj marrëveshjeje shumë të dëmshme. Kjo kryekëput është meritë e Ramush Haradinajt dhe kjo nuk mund të kundërshtohet me asgjë. AAK-ja duhet të luajë rolin e opozitës konstruktive.

5. Lista Serbe: Është një parti fashiste që nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe është kanceri i Serbisë në trupin e njomë të Kosovës. Për të nuk votuan serbët e Kosovës, por ishte vetëm një votë, ajo e Aleksandër Vuçiqit dhe e Serbisë që terrorizuan serbët e Kosovës të cilët nuk u mbrojtën as nga partitë politike kosovare e as nga autoritetet ndërkombëtare.

Tash do ta shohim se si Kurti do ta fillojë dialogun me serbët e Kosovës e jo me Beogradin, siç ka premtuar!

6. Nisma-AKR-PD: Gjithmonë kam theksuar se Nisma - AKR e kalon pragun pa asnjë problem, kurse Nisma + AKR nuk e kalon pragun dhe, si duket, ashtu do të bëhet! Nëse ndodhë kështu, atëherë zhduket përfundimisht mundësia e shantazhit që ua bënte AKR-ja të tjerëve. Shantazhimi i AKR-së, sa ishte krejtësisht i pamoralshëm, ishte edhe kriminal. Kjo tash është punë e paqte.

Përfundim: Ende nuk mund të themi se kanë mbaruar punët. Është një koalicion i projektuar më herët midis LV-së dhe LDK-së, por se tash me forcimin e pozicionit negociues (shantazhues) të LDK-së, si kompromis mund të bëhet formula: LV-ja postin e kryeministrit dhe 30-35 për qind të ministrive, kurse LDK-ja postin e kryeparlamentarit dhe 65-70 për qind të ministrive. Në çdo variant, nëse për shkak të kombinimeve të ndërkombëtarëve PDK-së i ofrohet pjesëmarrja në qeveri, në asnjë rrethanë nuk duhet ta pranojë. LV-ja dhe LDK-ja i kanë siguruar besoj 61 vota shqiptare dhe nuk varen aspak nga Lista Serbe kur duhet të votohen ligjet me një shumicë të thjeshtë, kurse aty ku duhen dy të tretat e votave, në raste shumë të rralla, PDK-ja dhe AAK-ja duhet të votojnë, pa asnjë kushtëzim. Në këtë kontekst e them se edhe PDK-ja edhe AAK-ja duhet ta votojnë Qeverinë Kurti pa asnjë hezitim dhe qysh tani ta bëjnë këtë përkrahje. Në rast se LV-LDK bëjnë ndonjë veprim represiv kundër opozitës e nuk e besoj se do ta bëjnë këtë, atëherë krijohet një situatë tjetër. Qeveria Kurti duhet të bashkëpunojë me Brukselin dhe Uashingtonin, por gjithnjë duke mbrojtur interesin e Kosovës duke ua bërë të ditur se nuk bisedohet për territore e as për Republika Serpska në Kosovë! Tash, Albin Kurti, nëse bëhet kryeministër, duhet të flasë edhe në emër të opozitës sepse do të jetë edhe kryeministër i tyre. Kosovën e presin shumë probleme ekonomike, sociale e sidomos politike. Buxheti i Kosovës është thuaja buxhet social, kurse çdo infuzion financiar nga Perëndimi do të kushtëzohet me lëshime dhe dëgjueshmëri politike. Për këtë arsye shkrimin e fundit e kam titulluar: "Fituesi i zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 do të jetë humbësi më i madh". Ende nuk kam ndryshuar qëndrim! Është ngritur shumë tym, të presim të kalojë euforia dhe të lëshohen gjërat në tokë dhe për toke.



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

BE: Propozimi i Johnsonit për Brexit, i papjekur

BRUKSEL, 7 TETOR - Komisioni Evropian deklaroi se Britania e Madhe duhet të paraqesë menjëherë një zgjidhje të realizueshme, para zhvillimit të samitit të liderëve të BE-së për negociatat e Brexit-it dhe jo marrëveshje të papjekur për kufirin irlandez. "Liderëve të BE-së u duhet kohë për t'u përgatitur për këtë mbledhje", deklaroi zëdhënësi e komisionit, Mina Andreeva.

Britania e Madhe pritet të largohet nga BE-ja në fund të këtij muaji,

por ekziston një pasiguri e madhe në lidhje me kushtet e daljes, pasi Londra kërkon të bëjë ndryshime të minutës së fundit.

Kryeministri britanik, Boris Johnson propozoi javën e kaluar, një alternativë për marrëveshjen e "Backstopi-it", klauzolë kjo, në marrëveshjen e Brexit-it që synon t'i shmangë vështirësitë në kufirin irlandez.

Brukseli nuk pranoi sugjerimet, ndërsa Londra insiston që BE-ja duhet të përmbushë marrëvesh-

jen dhe të ofrojë lëshime.

Bisedimet mbi propozimet e Londrës u zhvilluan të hënën, ku sekretari britanik i Brexitit, Steve Barclay, takoi zyrtarët e BE-së në Bruksel, edhe pse të dyja palët refuzojnë të bëjnë lëshime. "Britania e Madhe ka bërë një ofertë shumë të rëndësishme, por është momenti që Komisioni Evropian të tregojë gatishmëri për të bërë kompromis. Në të kundërt, ajo do të largohet pa marrëveshje", deklaroi një burim zyrtar në Bruksel.



Palët shkëmbejnë akuza për skandalin me Ukrainën

Presidenti Trump shprehet i shqetësuar për korrupsionin në Ukrainë ku ai thotë se mund të ketë qenë i përfshirë kandidati kryesor demokrat në garën presidenciale, Joe Biden, kurse demokratët thonë se Trumpi ka tradhtuar betimin që ka bërë si president


UASHINGTON, 7 TETOR - Në Uashington po ndizet debati, ndërkohë që Dhoma e Përfaqësuesve vazhdon hetimet mbi presidentin Trump. Një tjetër person nga radhët e komunitetit të zbulimit ka raportuar se ka pasur aktivitete shqetësuese nga ana e presidentit në shkëmbimet me Ukrainën, siç shpjegon një jurist që përfaqëson dy zyrtarët e zbulimit, të cilët mbeten anonimë. Të dyja palët po shkëmbejnë akuza për shkelje.

Presidenti Trump shprehet i shqetësuar për korrupsionin në Ukrainë ku ai thotë se mund të ketë qenë i përfshirë kandidati kryesor demokrat në garën presidenciale, Joe Biden. Djali i Bidenit ka interesa biznesi në një kompani që është nën hetime në Ukrainë, ka njoftuar voa. Presidenti i kërkoi homologut ukrainas ta ndjekë këtë çështje kur zhvilloi një telefonatë me të, e cila nga kritikët shihet si presion mbi një udhëheqës të huaj

për të nxjerrë të palara për një rival politik në shkëmbim për mbi 400 milionë ndihma amerikane.

Një zyrtar i zbulimit raportoi me shqetësimin se kishte pasur shkelje. Thuhet se edhe një tjetër zyrtar ka raportuar tek Inspektori i Brendshëm i komunitetit të zbulimit, Michael Atkinson. "Trumpi është presidenti më i korruptuar që kemi pasur në historinë moderne. Ai është përkufizimi i korrupsionit", tha Joe Biden, kandidat demokrat në zgjedhjet presidenciale.

Presidenti i ka cilësuar hetimet një gjueti shtrigash e kryesuar nga demokratët në Kongres, përfshirë ligjvënësin Adam Schiff, kryetar i Komisionit të Dhomës së Përfaqësuesve për Shërbimet e Zbulimit. "Ky është një krim, një akt mashtrimi ndaj popullit amerikan, por do të punojmë së bashku me Adam Schiff dredharakun, me Nancy Pelosin dhe me të tjerët", tha



presidenti.

Trumpi tha se në fakt ai është personi që po zbulon shkelje. "Nuk dua t'ia di për fushatën e Joe Bidenit. Por më shqetëson korrupsioni", tha ai. Demokratët thonë se Trumpi ka tradhtuar betimin që ka bërë si president. "Kjo administratë, pa asnjë justifikim ngriu 391 milionë dollarë ndihma për Ukrainën që është në pozitë delikate. Më pas presidenti i bëri presion një udhëheqësi të huaj të ndërhynte në zgjedhjet e 2020 dhe të vinte në shënjestër një shtetas amerikan për përfitime

politike. Ky është përkufizimi i abuzimit të postit", tha ligjvënësi demokrat Hakeem Jeffries.

Senatori nga shteti Utah, Mitt Romney, një ndër kritikët e pakët të presidentit nga radhët e republikanëve, është shprehur se këto janë akuza shqetësuese. Një tjetër republikan thotë se Trumpi thjesht po bën detyrën. "Nëse do të dërgojmë këto fonde nga paratë e amerikanëve që i fituan me punë të fortë në ndihmë të Ukrainës që të përballojë kërcënimin rus, që të vazhdojë të përparojë në drej-

timin e duhur, që të marrë sistemet e sigurisë që i nevojiten, mendoj se presidenti beson se duhet të ketë më parë garanci që në atë vend nuk ka korrupsion", thotë ligjvënësi republikan Jim Jordan.

Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo është një ndër emrat e përmendur në këtë temë, pasi u tha se ai ishte i përfshirë në telefonatën me presidentin.

Mesazhe të shkëmbyera mes disa diplomatëve amerikanë tregojnë se edhe ata ishin të përfshirë prapa skenave.

Përleshje të dhunshme në Irak

BAGDAD, 7 TETOR - Autoritetet irakiane thanë të hënën se çdo pjesëtar i forcave të sigurisë do të mbajë përgjegjësi për çdo veprim të gabuar ndaj protestuesve antiqeveritarë. Ndërkohë ushtria po tërheq trupat nga pjesa verilindore e Bagdadit, një veprim që me sa duket kërkon të shmangë përshkallëzimin e situatës.

Gjatë natës të paktën 13 persona u vranë në përleshjet mes protestuesve e forcave të sigurisë. Që prej fillimit të protestave rreth një javë më parë,

janë vrarë më shumë se 100 vetë.

Një zëdhënës i Ministrisë së Brendshme të Irakut tha të dielën se 6,107 vetë janë plagosur, përfshirë dhe rreth 1200 forca të sigurisë. Sipas tij, tetë punonjës të sigurisë kanë vdekur në përleshje.

Protestat vazhduan edhe të dielën. Disa qindra protestues antiqeveritarë u mblodhën në periferi të kryeqytetit irakian. Sipas dëshmitarëve ushtria qëllon në drejtim të protestuesve dhe bllokoj një

rrugë kryesore pranë qytetit Sadr për të parandaluar përparimin e demonstruesve. Protestuesit i kanë zgjeruar kërkesat e tyre nga thjesht kërkesa për punë e shërbime më të mira, si ujë e drita, në thirrje për t'i dhënë fund korrupsionit në vendin e pasur me naftë me një popullsi prej rreth 40 milionë banorësh.

Të dielën qeveria publikoi një plan të ri reformash në një përpjekje për t'iu përgjigjur protestave që i gjetën autoritetet të papërgatitur.



Zbulime të reja për Rrugën e Qumështit, shpërtheu 3.5 milionë vite më parë

Një energji katalizike ka përfshirë galaksinë tonë, rrugën e qumështit, rreth 3.5 milionë vite më parë. Sipas një ekipi astronomësh, shpërthimi i quajtur prej tyre Seyfert, nisi afër një vrime të zezë super të madhe në qendër të galak-

sisë. Pasojat janë ndjerë 200 mijë vite dritë larg. Zbulimi se qendra e rrugës së qumështit ka qenë më dinamike nga sa mendohej më parë, mund të çojë në një riinterpretim të plotë të evolucionit të saj.

“Këto rezultate do të ndryshojnë dramatikisht njohuritë tona për rrugën e qumështit- thonë shkencëtarët nga universiteti i Sidneit në Australi. “Ne – shtojnë ata – kemi menduar gjithnjë për galaksinë tonë si një

galaksi jo aktive, me një qendër jo shumë të shndritshme”. Shpërthimi ka shkaktuar dy kone gjigande të jonizuara që janë shpërndarë nëpër rrugën e qumështit. Ekipi i shkencëtarëve i udhëhequr nga profesori Joss

Bland Hawthorn, nga Këshilli australian i kërkimeve, kanë përdorur të dhëna të mbledhura nga teleskopi hapësinor Hubble për të përlogaritur se kur një shpërthim masiv energjie të lartë ka ndodhur./ *Top Channel*



Mark Zuckerberg: Askush nuk meriton të ketë kaq shumë para

Mark Zuckerberg është personi i pestë më i pasur në botë duke zotëruar 70 miliardë dollarë dhe së fundmi është shprehur se miliarderët nuk meritojnë të kenë kaq shumë para.

Shefi ekzekutiv i Facebook bëri komentet gjatë një livestream në Q&A Facebook me punonjësit. “Nuk e di nëse e kam të saktë se sa para duhet të ketë dikush, por në njëfarë niveli askush nuk meriton të ketë kaq shumë para. Unë mendoj se nëse bëni diçka të mirë, ju shpërbleheni, por mendoj se disa nga pasuritë që mund të grumbullohen janë të paarsyeshme”, tha ai duke iu përgjigjur komenteve në lidhje me Bernie Sanders politikan amerikan. Sipas CNN, Zuckerberg vendosi ta bënte eventin e kompanisë në kohë reale, pasi dikush publikoi audion e një takimi të zhvilluar në korrik. “Q &As në Facebook janë një nga traditat e mia të preferuara dhe

pas publikimit të njëres prej tyre unë mendova se do të ishte mirë t’i tregojmë të gjithëve se si janë këto Q &As”, ka shkruar Zuckerberg në një postim në faqen e tij personale në Facebook. Ai u pyet se si mund të qëndronte i paanshëm për kandidatën presidenciale Elizabeth Warren pas deklaratave të së kaluarës për të, pasi ajo lëshoi një plan agresiv për gjigandët e teknologjisë. “Nëse ajo zgjidhet presidente, atëherë ne do të kemi një sfidë ligjore dhe unë do ta fitoj atë betejë. Nëse dikush përpiqet që të kërcënojë diçka që ekziston, ti shkon në betejë dhe lufton”, është shprehur Zuckerberg. / KultPlus.com



E rrallë

Zbulohet qyteti antik në Tel Aviv në vendin ku do të ndërtohej një autostradë

Arkeologët izraelitë pretendojnë se kanë gjetur një qytet të lashtë 5 000 vjet të vjetër në veri të vendit. Autoriteti izraelit i antikitetëve ka theksuar se qyteti antik ishte zbuluar gjatë punës përgatitore për të ndërtuar një autostradë afër Harish, një qytet 50 kilometra në veri të Tel Avivit. Ata e quajtën sajtin një "qytet kozmopolit dhe i planifikuar" që daton nga epoka e hershme e



bronzit. Qyteti shtrihet 65 hektarë dhe llogaritet të ketë pasur një popullsi prej rreth 6 000 banorësh. Gjatë punës, arkeologët kanë zbuluar një tempull ceremonial të pazakontë, kockat e kafshëve të djegura, një skulpturë me kokë njerëzore, si dhe fragmente qeramike dhe enë prej guri.

FOTO E DITES



Një fermer vjel hurma në një fermë në Deir el-Balah, Rripi i Gazës. /AP/

E jashtëzakonshme

Kërpudha që të mbytë vetëm me një të prekur

Një kërpudhë e rrallë që gjendet në Azi dhe në veri të Australisë është aq vdekjeprurëse sa mund ta helmojë njeriun vetëm me një të prekur. Vetëm po të preket kjo kërpudhë e depërton helmin nën lëkurë dhe shumë shpejt viktima do të ketë rënie flokësh, dëmtime në tru,



rënie të lëkurës dhe simptoma të tjera të tmerrshme që mund të çojnë në vdekje.

BARSOLETA E DITËS



Së shpejti martesat do të duken kështu:
Ofiqari: A pranoni që ta ndryshoni statusin tuaj në 'Facebook' nga single në married.
Nusja: Po.
Ofiqari: I lus kumbarët të afrohen dhe të klikojnë like!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 16:00 Toy Story 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi;
1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

Regjia: Josh Cooley



Në ora 18:00 dhe 20:00

AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

Rolet: Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray




Çdo ditë në ora 22:00

DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

Rolet: Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

Regjia: Michael Engler




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI
Kjo ditë do të jetë neutrale dhe me kalimin e orëve, Venusi nuk do të ketë më ndikim negativ.



DEMI
Ju pret një ditë stresuese dhe konfuze. Gjatë kësaj jave do të keni shumë gjëra për të bërë dhe për të zgjidhur në nivelin ligjor.



BINJAKËT
Gjërat po ndryshojnë gradualisht për më mirë dhe fundi i muajit do të shënojë kthesën e bujshme.



GAFORRJA
Gjatë kësaj dite do të ketë armëpushim, i cili ju përgatit për një periudhë rikuperimi në dashuri. Venusi do të ketë ndikim tranzit në shenjë.



LUANI
Mund të jeni të inatosur me dikë, i cili nuk ka treguar besim tek ju. Do të ndiheni edhe disi të lodhur.



VIJGJËRËSHA
Ju pret një ditë pozitive e cila paralajmëron një javë të mbushur me energji, gjatë së cilës do të keni mundësi të shumta për t'u kapur fluturimthi.



PESHORJA
Jeni përpara një dite të lodhshme dhe stresuese sidomos në punë, pasi mund të jeni duke bërë shumë gjëra njëkohësisht.



AKREPI
Ju pret një ditë nën ritmin e duhur, por që do t'ju bëjë të durueshëm, pasi yjet me kalimin e orëve do të jenë në anën tuaj.



SHIGJETARI
Mundohuni që të jeni më optimist. Edhe nëse gjatë këtyre ditëve nuk po ndodh asgjë e jashtëzakonshme, do të shihni se shumë shpejt diçka shumë e bukur do të vijë.



BRICJAPI
Ju pret një ditë neutrale, e cila paralajmëron një periudhë me angazhime dhe kënaqësi të mëdha. Do t'ju duhet ta kuptoni drejtimin e jetës suaj.



UJORI
Ju pret një ditë e mbushur me nervozizëm për shkak të shumë gjërave që duhet të bëni njëkohësisht.



PESHQIT
Dashuria do të jetë protagonistja e ditës. Do të jeni mjaft të ndjeshëm dhe entuziast.

Roza Lati puth në buzë gazetarin shqiptar në mes të emisionit



Embani mend kur Roza Lati ishte puthur me Feron në sezonin e kaluar të "Why not?". Kjo skenë ka ndodhur sërish, por këtë herë moderuesja ka puthur gazetarin e njohur të cilin e kishte të ftuar. "Jo për të bërë qejfin se i kam inat këta njerëzit lajkatarë që të marrin më të mirë, por

goça si ty i duhen më shumë shoubizit shqiptar dhe jo vetëm. Pa komplekse, me një super guxim. Të kam ndjekur që në fillim, lija punët për të të parë", është shprehur Ronaldo Sharka për Rozën. "O Zot, është një fans i vërtetë", ka thënë Roza dhe papritur e ka puthur në buzë Ronaldon.

Granit Xhaka bëhet baba për herë të parë



Futbollisti i njohur shqiptar është bërë baba për herë të parë. Leonita, bashkëshortja e Granit Xhakës, ka sjellë sot në jetë vogëlushen e tyre. "Mirëerdhe princesha jonë e vogël! Mami dhe babi të duan

shumë", ka shkruar Graniti në llogarinë e vet në "Instagram". Në fotografiminë e publikuar duket dora e çiftit së bashku me atë të vogëlushes së porsalindur, por Graniti nuk e ka zbuluar se si do ta quajnë vajzën.



Dua Lipa: Ironike, por muzika iu bën keq këngëtarëve

Dua Lipa ka thënë se muzika iu bënë mirë të gjithëve, por jo këngëtarëve dhe muzikantëve. Teksa ka folur për revistën "Billboard", Dua ka thënë se për njerëzit e thjeshtë këngët janë si një terapi, por kjo nuk vlen për muzikantët. "Është e dhimbshme dhe ironike që muzika ka një fuqi të tillë për të na bërë të lumtur, por muzikantët vuajnë në mënyrë nga çështjet e shëndetit mendor", ka

thënë 24-vjeçarja. Frika nga vetmia, dështimi dhe presioni nga rrjetet sociale janë pikat kyçe që, sipas Duas, ndikojnë në gjendjen mendore dhe emocionale të këngëtarëve. Këngëtarja me famë botërore i ka bërë apel industrisë së muzikës që t'i marrë seriozisht këto paralajmërime para se të jetë shumë vonë. Sipas studimeve, rreth 73 për qind e muzikantëve të pavarur kanë probleme shëndetësore.

Loredana pozon nga shtrati, duket sikur nuk ka veshur asgjë

Reperja e njohur shqiptare Loredana Zefi e ka ndarë me ndjekësit e vet në "Instagram" një foto nga shtrati. Në fotën e postuar ajo shihet e shtrirë dhe e mbuluar në disa pjesë të trupit, ndërsa pjesa ku shihet na lë të dyshojmë se ajo nuk ka veshur asgjë. Loredana vazhdon të jetë aktive në rrjete sociale.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Challandesi: Duhet të fitojmë ndaj Malit të Zi

Fitorja është synim i Kosovës në ndeshjen ndaj Malit të Zi për kualifikimet në Kampionat Evropian. "Po e fillojmë një javë që është shumë e rëndësishme për ne. Ndeshja me Gjibraltarin është një mundësi për t'i qartësuar disa gjëra në kokën time, njëherësh do të jetë rast i mirë që t'u japim hapësirë për lojë futbollistëve që kanë luajtur më pak. Ndërkaq, sa i përket ndeshjes me Malin e Zi, ajo është shumë e rëndësishme, sepse ka një ekip shumë të mirë. Duhet të fitojmë ndaj tyre për ta vazhduar ëndrrën për kualifikim", ka thënë Challandesi



ekipin. Nuk duhet të mendojmë se jemi më të mirët, por duhet të luftojmë në çdo ndeshje. Tash është koha të luftojmë, që kjo mundësi të bëhet objektiv dhe realitet, pra kualifikimi", ka shtuar ai.

Lajm i mirë për trajnerin dhe ekipin përfaqësues të Kosovës është rikthimi nga lëndimi i Milot Rashicës dhe lojtarëve të tjerë. "Rashica e ka rikthyer besimin dhe ka luajtur 90 minuta. Ai është shumë i rëndësishëm për ne. Halimi është i suspenduar, kurse Shala ka një problem të vogël dhe do ta shohim. Sa i përket Benjamin Kolollit, jam i lumtur që ai luajti 30 minuta në ndeshjen e fundit për ekipin e vet dhe që tani do ta kemi në dispozicion. Celina e kishte një javë të vështirë dhe të lodhshme, duhet të shohim", ka deklaruar Challandes. Përfaqësuesja e Kosovës e zhvilloi stërvitjen e parë të hënën në mbrëmje në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë.

EPOKA E Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 TETOR - Trajneri i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Bernard Challandes, ka thënë të hënën në konferencë për medie, se "Dardanët" duhet të shënojnë fitore në ndeshjen kualifikuese ndaj Malit të Zi nëse dëshirojnë që ta vazhdojnë ëndrrën për kualifikim

në Kampionatin Evropian. Kosova kualifikuesen ndaj malazezëve e zhvillon më 14 tetor, por paraprakisht e zhvillon më 10 tetor miqësoren kundër Gjibraltarit. Challandesi e vlerësoi të rëndësishme edhe këtë përballje, sepse synon që t'ua japë rastin edhe disa futbollistëve të rinj. "Po e fillojmë një javë që është shumë e rëndësishme për ne. Ndeshja me

Gjibraltarin është një mundësi për t'i qartësuar disa gjëra në kokën time, njëherësh do të jetë rast i mirë që t'u japim hapësirë për lojë futbollistëve që kanë luajtur më pak. Ndërkaq, sa i përket ndeshjes me Malin e Zi, ajo është shumë e rëndësishme, sepse ka një ekip shumë të mirë. Duhet të fitojmë ndaj tyre për ta vazhduar ëndrrën për kualifikim", ka thënë

Challandesi. Trajneri zviceran ka kërkuar që të largohet vëmendja nga ajo se Kosova është ekip më i mirë se Mali i Zi, por futbollistët duhet të vazhdojnë të angazhohen dhe luftojnë nëse mendojnë për fitore. "Përballja me Malin e Zi është e rrezikshme. Lojtarët i kanë merituar komplimentet për punën e bërë deri tash, por kjo paraqet rrezik për

Ballkani njofton Dallkun me humbje, Feronikeli merr një pikë në Mitrovicë

Ballkani e fitoi derbin ndaj Prishtinës dhe është ngritur në pozitën e parë në renditjen tabelore, kurse kampioni në fuqi të Superligës, Feronikeli, luajti baras me Trepçën '89 sikurse që luajtën edhe Vushtrria dhe Flamurtari. Dy ndeshjet e fundit për xhiron e nëntë zhvillohen sot nga ora 14:30



EPOKA E Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 TETOR - Një fitore dhe dy barazime janë regjistruar në tri ndeshjet e javës së nëntë që u zhvilluan të hënën në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Ndeshja derbi, e zhvilluar në Suharekë, i takoi Ballkanit që e fitoi përballjen me Prishtinën (1-0). Pjesa e parë e ndeshjes u mbyll 0-0, kurse në minutën e 56 Blend Baftiu me kokë shënoi gol pas një asistimi të Jetmir Topallit. Kryeqytetasit u munduan ta barazojnë rezultatin, por i pakalueshëm

ishite portieri Ruxhi. Pas tri pikëve të fituara në këtë ndeshje, ekipi i drejtuar nga Ismet Munishi ngritët në pozitën e parë me 20 pikë, kurse Prishtina mbetet në pozitën e gjashtë me 13 pikë. Duhet cekur se kjo ishte humbja e parë për Armend Dallkun në krye të skuadrës "bardhekaltër". Ndeshje interesante ishte edhe ajo në mes të Trepçës '89 dhe Feronikelit, e cila u zhvillua në stadiumin "Riza Lushta" dhe përfundoi me rezultat 1-1. Për vendësit golin e vetëm e shënoi Gëzim Rusi në minutën e 44-t. Ndërsa skuadra mysafire e barazoi rezultatin në

pjesën e dytë nëpërmjet Mendurim Hotit (76). Pas kësaj ndeshje, 89-shi e forcon pozitën e shtatë me 10 pikë, kurse "Nikli" pozicionohet e katërta me 16 pikë të grumbulluara. Humbjes i shpëtoi edhe Flamurtari, ani pse ishte duke humbur me dy gola dallim, arriti të rikthehet dhe ta barazojë rezultatin në ndeshjen ndaj Vushtrrisë (2-2). Vendësit pas gjysmë ore lojë kaluan në epërsi me golin e Klevis Lushtakut, kurse Mathues e shtoi epërsinë e Vushtrrisë në 2-0. Për vendësit realizuan Egzon Krasniqi

dhe Torivoll Stullqaku. Pas kësaj ndeshje Vushtrria është në pozitën e parafundit me 6 pikë, kurse Flamurtari në pozitën e dhjetë me 8 pikë.

Dy ndeshjet e fundit të javës së nëntë në elitë zhvillohen sot (e martë) nga ora 14:30. Gjilani e pret skuadrën e fundit në tabelë, Dukagjinin e Klinës dhe synim e ka që t'i arketojë tri pikë të reja në garën për kreun e tabelës. Ndërsa ndeshje interesante do të zhvillohet edhe në Skenderaj, ku Drenica e pret Dritën e cila llogaritet favorit për ta fituar këtë përballje.

Humbje e thellë për Vëllaznimin në Ligën e Parë

Skuadra e Vëllaznimit nga Gjakova është duke kaluar nëpër një krizë të jashtëzakonshme, pasi pësoi humbje edhe në ndeshjen e zhvilluar të hënën nga Vllaznia e Pozharanit (1-4). Humbje pësoi edhe Malisheva

në përballje me Trepçën (1-0), kurse Besa si mysafire arriti fitore ndaj Ulpianës (0-2). Istogu e KEK-u u ndanë miqësisht (1-1) në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Demush Mavraj".

IPKO SUPERLIGA

Ballkani - Prishtina	1-0
Trepça '89 - Feronikeli	1-1
Vushtrria - Ferizaj	2-2
Llapi - Ferizaj	2-4

Të martën takohen:
Gjilani - Dukagjini
Drenica - Drita

LIGA E PARË

Drenasi - Ramiz Sadiku	1-0
Trepça - Malisheva	1-0
Istogu - KEK-u	1-1
Ulpiana - Besa	0-2
Vëllaznimi - Vllaznia (P)	1-4

Të martën takohen:
Onix - 2 Korriku
Arbëria - Vitia
Liria - Dardana

Shaqiri: Në Liverpool shpesh me quajnë legjendë

LIVERPOOL, 7 TETOR - Sulmuesi i Liverpoolit, Xherdan Shaqiri, ka folur në lidhje me momentin e vështirë që po kalon. Ai ka pranuar se po vuan shumë prej faktit që nuk po merr shumë minuta, por nga krahu tjetër beson se është një nga liderët e skuadrës. Shqiptari ka pranuar se nuk ka probleme

me trajnerin Jurgen Klopp, madje e vlerëson dhe i pranon zgjedhjet e tij. "Jam i zhgënjyer që nuk po marr minuta, sigurisht. Nëse ky nuk është reagimi i një lojtari profesionist, atëherë ai po merret me sportin e gabuar. Klopp nuk mund të diskutojë me çdo lojtar zgjedhjet e tij, është normale. Ne

kemi shumë talente në skuadër dhe shumë prej tyre presin shansin. Nuk kam pasur kurrë probleme me trajnerin. Ai e di se jam gati. Nuk jam penduar që zgjedha Liverpoolin. Kalova nga rënia nga kategoria me Stoke te fitimi i Ligës së Kampionëve", ka thënë Shaqiri. "Isha titullar në

gjysmëfinalen e kthimit kundër Barcelonës që do të mbetet në historinë e klubit. Kam shënuar kundër Manchester Unitedit dhe shpesh më quajnë legjendë këtu. Mendoj se jam pjesë e rëndësishme e grupit dhe një nga liderët e skuadrës me përvojën që kam", ka deklaruar Shaqiri.



Behrami: Vendimi për ndarje ishte i përbashkët

SION, 7 TETOR - Ka zgatur më pak se 3 muaj përvoja e Valon Behramit te Sioni në Superligën e Zvicrës. Futbollisti shqiptar, që deri pak kohë më parë përfaqësonte Zvicrën në

rang kombëtaresh, ka prishur marrëveshjen me klubin. 34-vjeçari nuk i ka bërë të qarta arsyet, por ka treguar se të dyja palët kanë rënë dakord për të mos e vazhduar

bashkëpunimin. "Historia jonë nisi mirë, por arsye të ndryshme sollën situatën aktuale. Në fund vendosëm të thoshim lamtumirë në mënyrën më të mirë të mund-

shme. Vendimi ishte i përbashkët", ka thënë Behrami, i cili në këtë sezon ishte aktivizuar në vetëm 4 takime në Superligën e Zvicrës për një total prej 301 minutash.



Cikalleshi: Në Turqi na kënaq vetëm fitorja

Tiranë, 7 tetor - Një nga futbollistët që e njeh më mirë përfaqësuesen turke është pikërisht Sokol Cikalleshi, i cili po luan sezonin e tij të 5-të në Turqi. 29-vjeçari po kalon një moment të shkëlqyer forme si me kombëtaren shqiptare ku ka shënuar në tri sfidat e fundit, po ashtu edhe me klubin e tij Akhisarspor dhe peshën e sulmit të Shqipërisë të premtën në Stamboll do ta mbajë pikërisht ai. Në konferencën për shtyp të kësaj të hëne Cikalleshi u shfaq optimist se kuqezinjtë mund ta mposhtin Turqinë për ta vazhduar ëndrrën "Euro 2020". "Për ta vazhduar ëndrrën, Islanda ishte si finale. Bëmë gjysmën e punës me atë ndeshje,



dhe kjo është diçka e mirë e shpresoj të na ndihmojë. E njoh Turqinë sepse kam luajtur, por nuk mund të them se do të jem pikë referimi sepse e di trajneri, por nëse jam në fushë, mund të them se do të jetë ndihmë për mua sepse i njoh. Mbetet t'i shohim zgjedhjet. Skuadra turke ka elemente të mirë dhe futbollistë që luajnë në liga të forta. Kjo ndeshje luhet në fushën e tyre dhe ato janë favorite. Mund ta kujtojmë ndeshjen në Shkodër, por ishte në rrethana ndryshe. Turqia është cilësore dhe ekipet kanë çase të mira dhe të këqija. Me trajnerin Reja në aspektin personal jam ndjerë mirë dhe po gjej vetveten e këtë e kam shfaqur në fushë duke shënuar. Kam marrëdhënie të mirë dhe jam i lumtur nëse vazhdon këtu si trajner, por mendoj se edhe shumë të tjerë mendojnë këtë gjë.

por pa rezultat pozitiv në Turqi nuk vlen ajo. Morali është i mirë pas asaj fitoreje me rezultat të mirë. Me ndeshjen e Turqisë kemi të njëjtën situatë që pa njërin nuk vlen tjetra. Unë e di që ëndrra për kualifikim është e vështirë dhe nëse arrijmë të fitojmë, nuk e kemi lehtë me Andorrën dhe Moldavinë. Turqia fitoi me Andorrën në minutën e 90. Jemi në rrugën e duhur, me ardhjen

e Rejës gjërat kanë ndryshuar për mirë dhe flas edhe në aspektin personal, pasi kam arritur të shënoj. Është një rrugë e gjatë dhe hap pas hapi hedhim themelet për Botërorin e ardhshëm, por jemi edhe në garë për këtë evropian", ka thënë Cikalleshi. "Futbollistët po marrin minuta dhe kjo është nga më të rëndësishmet dhe do të jemi mirë. Po shënojmë ne sulmuesit

Është Federata ajo që vendos në fund, por ne duam të vazhdojmë", ka deklaruar sulmuesi kuqezi. Sokol Cikalleshi është i kënaqur që ka arritur të shënojë në ndeshjet e fundit me klubin e tij. "Për një sulmues janë golat që e motivojnë dhe na bëjnë të punojmë më shumë për ndeshjet në vazhdim. Jam mirë dhe i gatshëm të jap maksimumin në Kombëtare", ka shtuar Cikalleshi.

Trajneri i Turqisë: Duhet të kemi kujdes nga Shqipëria

STAMBOLL, 7 TETOR - Trajneri i Kombëtares turke, Senol Gunes, në konferencë për shtyp, përpara ndeshjes me Shqipërinë dhe Francën, që do të luhen më 11 dhe 14 tetor. Gunes është shprehur se Turqia duhet të ketë kujdes, pasi Shqipëria do të vijë me qëllimin të fitojë. "Ndeshjet e Shqipërisë dhe Francës janë të rëndësishme. Dy ekipe të ndryshme. Franca është favorite e grupit. Ne do ta luajmë ndeshjen e vendit të parë në grup me të. Qëllimi ynë është të fitojmë. Prioriteti ynë do të jetë Shqipëria. Kjo do të jetë ndeshja jonë më e rëndësishme në katër ndeshjet e mbetura. Shqipëria është një skuadër me lojtarë të mirë në ligat kryesore evropiane. Ne duam të fitojmë me mbështetjen e tifozëve", ka thënë Gunes. "Shqipëria është një skuadër me



lojtarë të mirë. Trajneri i saj është i njohur në Itali dhe me përvojë. Ata kalojnë nga skema 3-5-2 në 5-3-2. Janë luftarakë dhe kompakt në mbrojtje. Nëse keni një mendim negativ për Shqipërinë, duhet ta harroni. Ne duhet të jemi një ekip

agresiv duke vrapuar po aq shumë sa ata. Ata mundohen të luajnë topin, nuk luajnë totalisht në mbrojtje si Moldavia apo Andorra. Kthehen në mënyrë të suksesshme nga mbrojtja me tre tek ajo me pesë", ka deklaruar Gunes.

SHKURT

Shtohen 2 pista të reja në kalendarin e Formulës 1

Federata Ndërkombëtare e Automobilitimit (FIA) ka zyrtarizuar kalendarin e garave të vitit 2020 në Formula 1. Ashtu sikurse që ishte vendosur që më parë, do të jenë 22 gara në kampionat. Sezoni do të nisë më 15 mars, në Australi dhe do të përfundojë më 29 nëntor, në Abu Dhabi. Do të jenë 7 fundjava dyshe, ku do të garohet dy të diela radhazi. Risi është përfshirja në kalendar e garës së Holandës, që pritet të zhvillohet në pistën e Zandvoort, ashtu sikurse gara e Vietnamit. Largohet gara e Gjermanisë.

Conte: Juve është në një kategori tjetër

Trajneri Antonio Conte, pas derbit të Italisë, të fituar 1-2 nga Juventus në "San Siro", ka thënë se skuadra e tij duhet të punojë shumë për ta arritur nivelin e bardhezinjve. "Juventus është i një kategorie tjetër në të gjitha pikëpamjet. Ne po tentojmë ta ngushtojmë këtë hendek. Ishte një sfidë e ekuilibruar, por edhe në këtë ndeshje përdorën të gjithë artilerinë e rëndë dhe aftësinë për t'i menaxhuar si duhet të tilla sfida. Ne duhet të rritemi. Gjithsesi, jam krenar për atë që bënë djemtë e mi. Komplimente edhe atyre, por duhet t'i përveshim mëngët dhe të vazhdojmë të punojmë", ka thënë Conte.

Guardiola beson në titullin e Premierë Ligës

Manchester City pësoi humbje 2-0 nga Wolvesi dhe tani është tetë pikë larg nga Liverpooli. Pavarësisht prej kësaj difference, trajneri Pep Guardiola është optimist se City mund të dalë sërish e para. "Unë i njoh këta djem. Ata janë akoma të mrekullueshëm dhe akoma e dinë se mund ta bëjnë atë", ka thënë Guardiola.

Nadali: Me Federerin mund të vlerësojmë e admirojmë atë që jemi duke bërë së bashku

Marrëdhënia mes dy tenisistëve, Rafael Nadal dhe Roger Federer, konsiderohet si një nga më të bukurat në botën e sportit. Jo vetëm për atë që ata kanë dhënë në fushën e lojës, por edhe për respektin që kanë jashtë saj. Pas turneut të Laver Cup, zhvilluar pak ditë më parë në Gjenevë, ka qenë Nadal ai që ka folur për marrëdhënien me Federerin: "Nuk është e vështirë ta ndash rivalitetin nga miqësia. Ne nuk jemi më 20-vjeçar, ndaj mund të vlerësojmë e admirojmë atë që jemi duke bërë së bashku". Federeri, fitues i 20 grand slameve, ka qenë i pranishëm edhe në ceremoninë e inaugurimit të Akademisë së Nadalit (19 gram slam) në Majorca pak kohë më parë. Ata kanë luajtur së bashku në lojën dyshe në turneun e Laver Cup të vitit 2017, duke fituar.

Allegri shihet si zëvendësues i Solskjaerit

Pozita e trajnerit të Manchester Unitedit, Ole Gunnar Solskjaer po "dridhet" akoma më shumë pas humbjes në ndeshjen e fundit nga Newcastle (1-0). Vetëm 9 pikë në 8 ndeshje e bëjnë shumë të vështirë situatën për norvegjezin i cili rrezikon të shkarkohet që në fillim të tetorit. Nëse situata nuk do të ketë përmirësim të menjëhershëm, Solskjaer do të largohet dhe klubi do të kërkojë për zëvendësuesin e tij. Siç raporton "La Gazzetta Dello Sport", Massimiliano Allegri është opsioni numër një për "dajtë e kuq", për ta marrë drejtimin e klubit. Italiani është me përvojë të madhe dhe pëlqehet shumë nga klubi anglez.



Në pajtim me nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Paneli për përzgjedhjen e anëtarit joekzekutiv të Bordit të BQK-së, publikon:

Shpallje

Për pozitën e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Profili i kërkuar:

- Person me integritet dhe përgatitje universitare;
- Minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitet apo çështje juridike;
- Njohuri në krijimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të rëndësishme të lidhura me misionin, objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Në mënyrë specifike të plotësojnë kushtet sipas nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-ën;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera paraqet përparësi.

Emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar nga data e emërimit.

Lista e kandidatëve që kualifikohen nga ana e Panelit do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili do të përzgjedh një individ. Miratimi dhe emërimi për këtë pozitë do të bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 84 paragrafi 27, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-ën.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV me detaje dhe një letër motivuese përmes email adresës vijuese: pancli@bqk-kos.org ose në dorë në zarf të mbyllur në arkivin e BQK-së, Rruga Garibaldi nr. 33 në Prishtinë, ose përmes postës në adresë të BQK-së: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (shënim: për pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të BQK-së), Rruga Garibaldi nr. 33,1000 Prishtinë, Kosovë.

Afati i fundit për aplikim është 24 tetor 2019, në orën 16:00.

Vetëm kandidatët e të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit do të thirren për intervistë.



U skladu sa članom 38. Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj Banci Republike Kosovo (CBK), Panel za izbor neizvršnog člana Odbora CBK-a, objavljuje:

Oglas

Za poziciju jednog neizvršnog člana Odbora Centralne Banke Republike Kosovo

Traženi profil:

- Osoba sa integritetom i univerzitetskim obrazovanjem;
- Minimum deset (10) godina profesionalnog ili akademskog iskustva u oblastima ekonomije, finansija, banaka, računovodstva ili pravnih pitanja;
- Znanje u stvaranju i nadgledanju sprovođenja značajnih politika vezanih sa misijom, ciljevima i obavezama CBK-a;
- Da specifično ispunjavaju uslove u skladu sa članom 40. Zakona br. 03/L-209 o CBK-u;
- Poznavanje engleskog i drugih jezika predstavlja prednost.

Imenovanje će biti u petogodišnjem mandatu, počev od dana imenovanja.

Lista kandidata koji se kvalifikuju od strane Panela dostaviće se Skupštini Republike Kosovo, koja će izabrati jednog pojedinca. Usvajanje i imenovanje za ovu poziciju će se obaviti od strane Predsednika Republike Kosovo u skladu sa članom 84. stav 27. Ustava Republike Kosovo i člana 38. stav 2. Zakona br. 03/L-209 o CBK-u.

Zainteresovani kandidati treba da dostave CV sa detaljima i motivaciono pismo putem sledeće email adrese: pancli@bqk-kos.org ili na ruke u zapečaćenoj koverti u arhivi CBK-a, ulica Garibaldi br. 33 u Prištini, ili putem pošte na adresu CBK-a: Centralna Banka Republike Kosovo (napomena: za poziciju neizvršnog člana Odbora), ulica Garibaldi br. 33,1000 Priština, Kosovo.

Poslednji rok za apliciranje je 24. oktobar 2019. godine, u 16:00 časova.

Samo kandidati koji ispunjavaju uslove konkursa će biti pozvani za intervju.



Lagja Ulpiana | Rr. Zija Shemsiu | Nr. 34 | Prishtinë | 10000 | Kosovë
T: 038 / 00 000 | F: 038 / 00 001 | E: office@ipko.net | W: www.ipko.com

FTESË PËR OFERTIM

IPKO Telecommunications LLC njofton të interesuarit se bën shitjen e kabllove koaksiale dhe fibrave të përdorura.

Dokumentacioni me kushtet e pergjithshme per shitjen e veturave mund të tërhiqet prej dates **08 deri me 11 Tetor 2019** në ndërtesën e IPKO-s në Rr. Zija Shemsiu nr.34, Ulpianë – Prishtinë.

Oferta duhet të dorëzohet në: IPKO Telecommunications LLC, Rr. Zija Shemsiu nr. 34, 10000 Prishtinë, Kosovë, jo më vonë se **18 Tetor 2019 në ora 14:00h.**

Nëse keni ndonjë pyetje sa i përket ftesës për ofertim, ju lutem na shkruani ne adresën elektronike procurement@ipko.com

Me respekt

IPKO Telecommunications
Rr. Zija Shemsiu nr.34 Ulpiane
procurement@ipko.com



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, Zyra e Personelit publikon këtë:

NJOFTIM PËR ANULIM

Njoftohen të gjithë aplikuesit që kanë konkuruar për pozitën: Arkëtar dhe Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative me nr.të referencës: IKSHPK /nr.1079/01 dhe nr.1080/01 të shpallur në Gazeten Epoka e Re dhe web faqe e IKSHPK-së, Anullohet konkursi për këto dy pozita.

Nga pjesëmarrësit në konkurs kërkojmë mirëkuptim.

OBAVEŠTENJE

Objavljaju se svi kandidati koji su se prijavili za posao: Službenik blagajnika i uprave informacionih tehnologija sa referentnim brojem: NIPHK / br.1079 / 01 i br.1080 / 01 objavljeni u novinama Epoka e Re i na veb lokaciji NIPHK, Konkurs za ove dve pozicije se poništava,

Od učesnika na konkursu tražimo razumevanje.

Për çdo informacion mund të kontaktoni zyren e personelit me nr. tel 038/541-432 lokali 1047, za sve informacije možete se obratiti kadrovskom odeljenju tel.br. 038/541-432 lok.1047

Prishtinë, dt. 07.10.2019



SHPREHJE INTERESI PËR PARTNERITET

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira për konsumatorët Telekom i Kosovës Sh.A., ftojmë kompanitë e interesuara që të bëhen pjesë e partneritetit kryesisht në instalim dhe shpërndarjen shërbimeve broad band (Internet Fiks) në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Bazuar në gjendjen aktuale të Telekomit të Kosovës Sh.A, limitimet/kufizimet financiare, ne presim çdo ide, propozim nga kushdo, krejt kjo për të ndihmuar dhe ofruar zgjidhje për tejkalimin – zbutjen e gjendjes aktuale.

Telekomi i Kosovës Sh.A synon që t'ju ofrojë kushte të barabarta të bashkëpunimit të gjithë operatorëve ekonomik serioz dhe të interesuar që të ofrojnë konsumatorëve përvijën më të mirë nga ky bashkëpunim. Synimi i partneritetit është përfitimi i tri palësh të përfshira në proces; Telekom i Kosovës, Konsumatori dhe Partneri.

Në funksion të realizimit të këtij bashkëpunimi, Telekom i Kosovës Sh.A tashmë ka përcaktuar si strategji partneritetin e mundshëm, por që këto ide, propozime do të duhet të precizohen pas propozimeve tuaja dhe pas takimeve të drejtpërdrejta. Ky është një proces i hapur dhe fillon një ditë pas publikimit të këtij njoftimi dhe vijon me lidhjen e marrëveshjeve të mes palëve.

Për të qenë pjesë e këtij partneriteti, fillimisht operatorët ekonomik/palët duhet:

- *Përshkrimi i fushëveprimtarisë së kompanisë, i cili duhet të jetë shitës i pajisjeve elektronike, telekomunikuese ose mediale, ISP në ndonjë lokacion, përvijë në fushën e instalimeve apo edhe KNOË HOË nga të tjerët, të ngjashme.*
- *Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (kopje) dhe Informatat e biznesit.*
- *Të kenë qarkullim vjetor në dy vitet e fundit fiskale (total të deklaruar) afërsisht ose mbi 1,000,000 Euro. Kjo kërkesë mund të plotësohet nga Operatori Ekonomik vetëm apo në konzorcium. Si dëshmi mund të përdoren Gjendja e tatimpaguesit e lëshuar nga autoriteti tatimor, ose Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare.*
- *Të dorëzojnë propozimet e veta, lidhur me idetë që kanë për bashkëpunim.*

Të gjitha kërkesat tuaja për të qenë pjesë e këtij partneriteti, së bashku me idetë dhe propozimet (modalitetet) e bashkëpunimit ju lutemi t'i dërgoni përmes postës elektronike në email adresën broadband_b2b@kosovotel.com

Prishtinë, 07 Tetor 2019

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Enver Haliti"

Komuna: Skenderaj

Data: 08.10.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/109-CS/1.5	Trajnim:Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe "Enver Haliti" Lubovec, Skenderaj.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatesisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme.

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e Teknologjisë (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën "Enver Haliti" Lubovec, Skenderaj, më së largu deri më datën; 16.10.2019

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termet e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Sami Bekteshi

Telefoni: 044/532-563

E-maili: bekteshisami@hotmail.com

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "ShFMU "GRNÇARE" – Grnçare dhe Novo Sello

Komuna: Prizren Data: 08 Tetor 2019

Emri i kontratës: Blerje e kompjuterve (lap top)

Numri i kontratës: ESIP/C1.3/085 - ESIP/SDG/085-G/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU „GRNÇARE“ Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:
 - **Blerje e kompjuterve**
 - Laptop - 3 copa**
2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
 - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën. Adresa e Shkolles SHFMU "GRNÇARE" – Grnçare dhe Novo Sello, Prizren më së largu deri më 18.10.2019.
4. Termet e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulenteve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Adis Mujo

Telefoni: 044 355 049

E-maili: adismujo@hotmail.com

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► D.P.Z. "Auto Domanik" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70226139 me pronar Zejnullah Domaniku Prishtinë.

► Shpend Jashari shpall të pavlefshëm INDEX-in, e Fakultetit Ekonomik në Kolegjin AAB, me nr: 0053/10-T.

► Ardian Musliu, shpall të pavlefshme diplomën e SHMT. Komunikacion rrugor "Anton Çetta" Skenderaj

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te banesat e bardha, afër Shkolles Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales